



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **28.02.2022**, me fillim në ora **10:00**. Mbledhjen e kryesoi: Kryesuesi i Kuvendit z. **Defrim Kafexhiu**. Konstatohet se kuorum, për mbajtjen e mbledhjes kemi:

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni t'iu përshëndes, i nderuar **Kryetar i Komunës z. Smajl Latifi**, nënkryetar i Komunës z. **Fatmir Iska**, të nderuar kuvendarë, drejtore të drejtorive komunale, përfaqësues të LMT-së, përfaqësues të mediave dhe ju gjithë të pranishëm!
Për këtë mbledhje sot propozojmë këtë:

REND DITE

RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 288 Nr. i faq./Br.stz./No.pg 1

Data/Datum/Date 28 / 02 / 2022

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për formimin e komisionit komunal të aksionarëve nga Komuna e Rahovecit për Ndërmarrjen Publike Lokale “ KRM Ekoregjioni “ ne Rahovec;
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për formimin e komisionit komunal të aksionarëve nga Komuna e Rahovecit për Ndërmarrjen Publike Lokale “ Stacioni i Autobusëve”ne Rahovec;
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për caktimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorit/eshës dhe zëvendësdrejtorit/eshës se institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese para universitare (IEAAP);
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për themelimin e Këshillit për Fshatin Hoçë e Madhe;
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për formimin e komisionit për vlerësimin e performancës së kontratës për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale;
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P- 71510057-01472-3 në Zonën Kadastrale ne Rahovec;
8. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P- 71510057-01997-10 dhe P-71510057-01997-11, në Zonën Kadastrale ne Rahovec;
9. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2021 ne vitin 2022;
10. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2022;
11. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për subvencionimin e lindjeve për gratë-nënat banorë të Komunës se Rahovecit për vitin 2022;

12. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për emërimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terrene për zgjedhjen e këshillave lokal;
13. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për emërimin e komisionit të ankesave për procesin e zgjedhjes së Këshillave Lokale;
14. Shqyrtimi i Raportit nga Komiteti për Komunitete për vitin 2021;
15. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet kuvendarëve.

Kryetari – I nderuar kryesues i kuvendit të komunës z. Defrim Kafexhiu, nënkryetar i komunës, anëtar të kuvendit të komunës, drejtor të drejtorive, media, përfaqësues që e mbikëqyrin këtë mbledhje të rregullte të kuvendit të komunës së Rahovecit. Në cilësinë e kryetarit të komunës i propozoj kuvendit të komunës së Rahovecit, që pika e 11-të e rendit të ditës ku bëhet fjalë për subvencionimin e lindjeve për banoret e komunës së Rahovecit, të tërhiqet nga rendi i ditës, ku janë disa arsye dhe arsyeja e parë është se ne kemi nevojë ende për disa shënime raporte analiza vlerësime dhe gjithashtu edhe një koordinim pak më me të mirë me drejtorinë e financave, pastaj arsye tjetër është se ka pasur vërejtje konstruktive në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, po ashtu arsye tjetër është se ne jemi duke marrë veprime investive në riparimin e objektit të maternitetit dhe presim që të kemi edhe një specialiste përveç dy gjinekologeve që të krijohen kushte edhe me të favorshme. Kështu që derisa nuk i kemi këto mundësi sot atëherë unë jam dakord që të hiqet nga rendi i ditës si propozues i saj e ftoj kuvendin që ta heq prej rendit të ditës me kusht që një të ardhme optimale që ta kemi përsëri si pikë të rendit të ditës. Qëllimi i jonë ka qenë që të mos krijojmë obligime për shkak se ka krijuar rritje dhe një nga pikat e para u deshtë me qenë edhe pika e subvencionimit të lindjeve, kështu që marr përsipër që në një të ardhme të afërt me një afat optimal që sapa të përfundojnë investimet pasi i kemi rekomandua edhe operatorit që të përshtatet punimet në repartin e gjinekologjisë ose të maternitetit dhe sapa të krijohen kushtet me të mira dhe modernizohet reparti atëherë ne do të kemi mundësi përsëri me diskutua. Kështu që kërkoj ndjesë rreth një analize të mirëfilltë të gjendjes momentale për shkak se ne presim raportet dhe vlerësime më serioze që të koordinojmë me drejtorinë e financave rreth riparimit dhe modernizimit të repartit dhe gjithashtu që ta kemi një situatë me të favorshme sa i përket resurseve profesionale pasi kemi nevojë edhe për një specialist të fushës si neонатolog që të krijojmë kushte të favorshme dhe sapa të kemi këto atëherë përsëri do ta kemi si pikë të rendit të ditës. Pra kërkoj mirëkuptim nëse ne nuk e kemi gjetur momentin me të përshtatshëm që me diskutua seriozisht për këtë pikë.

Burim Krasniqi – Meqenëse jemi para aprovimit të rendit të ditës, mendoj që është pjesë e detyrimeve jashtë rendit të ditës deri sa nuk kemi filluar. Unë kam një kërkesë dhe sugjerim, e para flas prej grupit të asamblistëve të LDK-së se nuk do të ishte problem me të mbajtur edhe dy seanca brenda muajit edhe me një kompensim të një seance pa pasur nevojë që me të kompensua të dyjat por vetëm që rendi i ditës me qenë me të shkurt që me të dhanë hapësirë me diskutua më shumë dhe me aq mundësi që dimë që me të shtjellua pikat, pasi vërtet mendoj se 15-të pika është ngarkesë. Pastaj e dyta, po besoj që pyetjet dhe përgjigjet e kuvendareve duhet me qenë pas procesverbalit pasi mendoj se është pjesë ku diskutohet dhe nëse lihet në fund atëherë mund të mos jetë prezent një drejtor apo kryetari mundet me pas obligime apo angazhime tjera ditore pasi është normal proces i punës së ekzekutivit dhe gjithashtu një sugjerim kam, pasi sot kam pranuar një përgjigje nga pyetja e seancës së kaluar nga drejtori i Arsimit z. Avni Morina, që do të ishte e udhës me pas një logo të komunës dhe një format me të mirë, pasi është shumë e thjeshtë dhe nuk mundesh me than se a është përgjigja e drejtorit pasi nuk ka as numër protokolli as vulë d.m.th. është një shkresë që

nuk mund te them se përgjigja është mirë apo keq asnjë paragjykim skam për këtë por vetëm me qenë e formatit që i plotëson standardet që me qenë dokument i besueshëm zyrtar për te ardhmen.

Bejtullah Deliu – Përshëndetje kryetar z. Smajl Latifi, nënkryetar, kryesues i kuvendit, drejtor te drejtorive dhe gjithë te pranishmit ne salle. Lidhur me kërkesën e kryetarit për tërheqjen e kësaj pike te rendit te ditës, po besoj që është ne rregull pasi janë vërejt disa ndryshime që janë diskutuar ne Komitetin për Politike dhe Financa, mirëpo kemi kërkuar që ne komitetin për politikë dhe financa te vihet kjo pike e rendit te ditës që na kanë dërguar materiale me kërkesën time personale që shuma që është caktuar që une e kam vlerësuar që është gabimisht vetëm për banoret e komunës se Rahovecit por që lindin ne QKMF „ Fahredin Hoti,, te përmirësohet dhe pa marr parasysh që ne Republikën e Kosovës kudo që lindin që te paguhet e njëjta shume për te gjitha gratë apo lehonat e komunës se Rahovecit. Pra ky tekst ne KPF është thënë që do te përmirësohet me një pike shtesë me kërkesën time që te ceket edhe kjo pike mirëpo nuk ka ardhur dhe e njëjta gjë u ardh sikur ne KPF. Kështu që do te ishte mirë që atë që kemi kërkuar apo vërejtjet që kemi bërë, te vije e kompletuar edhe këtu.

Besa BYTYQI – Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, nënkryetar, drejtor te drejtorive, kolegë këshilltar. Ne e mbështesim propozimin e kryetarit te komunës për tërheqjen e kësaj pike nga rendi i ditës, duke u bazuar ne informacionet dhe te dhënat që ende nuk i kemi dhe duhet ti kemi për te marr një vendim te mirëfilltë dhe gjithashtu edhe kryetari i shpalosi mendimet e tij si edhe e justifikoj kërkesën por gjithashtu edhe si sponsorizues i kësaj pike ka te drejtë edhe me rregullore që te tërheq nga rendi i ditës, kështu që ne jemi pro kërkesës se kryetarit te komunës.

Kryesuesi – Para se me fillua unë kërkoj mirëkuptimin nga drejtoret e drejtorive, që pas mbledhjes se KPF-së materiali që kërkohet nga anëtarët e komitetit te i bashkëngjitet materiali për seancën e rregullt dhe kjo mund te jetë çështje e kohës që për këtë mbledhje nuk e kemi pranuar materialin prej drejtoreshave për shkak te kohës se kufizuar që kemi pasur për thirrjen e seancës se rregullt por po besoj që kemi me hasur mirëkuptimin po nga te njëjtit drejtor ne seancat tjera. Kështu që para se me aprovua rendin e ditës, a ka diçka sa i përket këtij rendi te ditës, që me shtua apo me tërheq ndonjë pikë te rendit te ditës përpos kësaj që e tërhoqi sponsorizuesi ne këtë rast kryetari i komunës. Pra meqë nuk kemi, e qesim ne votim rendin e ditës, pa pikën e 11-të që e tërheqë kryetari i komunës. Atëherë me shumicë te votave miratohet rendi i ditës. Kalojmë ne pikën e parë te rendit te ditës.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Rumir Zhuniqi – Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, nënkryetar, drejtor te drejtorive, kolegë asamblastë, media dhe gjithë ju te pranishëm. Si anëtar i kuvendit kërkoj që ne procesverbalet e ardhshme te shënohen edhe votat se si kanë votuar anëtarët e kuvendit pro kundër apo abstenim pasi që kjo kërkohet edhe me rregullore te kuvendit dhe gjithashtu është edhe ne funksion te transparencës dhe llogaridhënies. Pra kërkoj që nga seancat e ardhshme te aplikohet kjo formë pasi është e specifikuar ne rregullore te kuvendit, që kjo i ndihmon transparencës që me ditë qytetaret se si kanë votuar.

Kryesuesi – PO besoj që edhe për këtë pikë do te hasim ne mirëkuptimin prej sekretarisë se kuvendit që te përfshihet me detajisht ne procesverbalin e mbledhjeve dhe te KPF-së që te vendoset procesi i votimit aty. Por gjithashtu kërkoj mirëkuptimin edhe nga ju që procesi i votimit te jetë me i ngadaltë që verifikimi i votave te jet me i lehtë.

Rumir Zhuniqi – Në këtë rast kërkoj nga sekretaria e kuvendit por gjithashtu edhe pushtetit lokal që te bëj formën ne mënyre elektronike te votimit që me pas mundësi me ditë se cili se qysh kemi votuar.

Burim Krasniqi – Kam një kërkesë për sekretarin e kuvendit, pasi seancat janë njëherë ne muaj dhe ka kohë te mjaftueshme dhe gjithçka është e incizuar dhe gjithashtu e kuptoj se ne procesverbal nuk shkruhet krejt ajo çka kemi fole por vetëm nuk duhet te i humbet kuptimi pasi ka ne disa raste që ka kuptimin e

humbur gjate diskutimit. Kështu që duhet me pas me shume kujdes rreth kësaj pasi është dokument që mbetet për te ardhmen.

Kryesuesi – Atëherë meqë nuk kemi tjerë te lajmëruar, e qesim ne votim pikën e parë te rendit te ditës. Konstatoj se me shumicë te votave aprovohet pika e parë e rendit te ditës. Para se me kalua ne piken e dytë te rendit te ditës, i lusë grupet e asamblistëve që emrat që do ti propozojmë për votim për komisionet komunale te aksionareve, pra do te kërkojmë prej grupeve te asamblistëve që te propozojnë nga një emër dhe secilin e emër do e qesim ne votim që te jemi te qartë dhe te shkoj me lehtë si proces. Kalojmë ne pikën e dytë te rendit te ditës:

2. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për formimin e komisionit komunal te aksionareve nga Komuna e Rahovecit për ndërmarrjen publike lokale “ KRM Ekoregjioni” në Rahovec.

Kryesuesi – Ky komision do te përbehet nga 3 anëtar, ku dy anëtar do te jenë nga kuvendi komunal dhe një anëtar emërohet nga kryetari i komunës. Kështu që fillimisht e ftojë nga grupi i AAK-së që te propozojnë një emër për anëtar ne komisionin komunal te aksionareve për ndërmarrjen publike “KRM Ekoregjioni “.

Besë BYTYQI – Faleminderit kryesues, grupi i AAK-së e propozon Hasan Përboqi.

Shqipe Kryeziu – Përshëndetje i nderuar kryetar, nënkryetar, drejtor te drejtorive ,kolegë asamblistë. Unë mendoj se pas propozimit te tre kandidateve, e me pastaj duhet ta qesim ne votim dhe jo për secilin veç e veç.

Burim Krasniqi - Unë po propozoj dhe po kërkoj që me qit ne votim formën e votimit, propozimi jonë për një kandidat për një anëtar te komisionit dhe që te votohet se a janë për me votua ne pako apo për secilin kandidat një nga një dhe me pastaj shkojmë ne formën e votimit ashtu siç dakordohet kuvendi.

Isak Hoti – Përshëndetje kryesues, kryetar, nënkryetar, drejtor, kuvendar dhe gjithë ju te pranishëm. Zakonisht shkon me komisione ku për një komision votohet jo individualisht pasi nuk mundesh me votue për secilin anëtar te komisionit. Pasi problemi është që po votohet për një komision që mund te votoni me votë te fshehtë ose mundeni me votua ne pako. Ne nuk mundemi me marr vendim për secilin, pasi është një vendim i përbashkët ne komision, pastaj duhet me qenë patjetër edhe gjinia për te dy gjinitë d.m.th. nuk mundesh me votua individualisht për secilin sepse votohet për me nxjerr një vendim. Por nëse voton individualisht për secilin atëherë duhet me nxjerr për secilin ka një vendim, kështu që nuk funksionon kështu dhe nuk kemi asnjë praktike e tillë që ka funksionua . Ky votohet si komision i përbashkët, ku grupet propozojnë dhe mbi bazën e propozimit nxjerrët edhe një vendim i tillë. Kështu që kryesuesit i them që me pas kujdes ne shkelje pasi pasojat e kësaj shkojnë te propozuesi dhe te nënshkruesi e ne këtë rast kryesuesi.

Burim Krasniqi - Unë po besoj që zyrtari ligjor duhet ten a jep bazën ligjor ne bazë te asaj që votohet kështu apo ashtu dhe jo me na dhanë sugjerime. Kur interpretohet kuptimi ligjor atëherë thotë neni dhe rregullorja e thotë kështu. Nuk qëndron se nuk kemi praktika pasi kemi praktika edhe ne kuvendin e Kosovës një nga një kalojnë dy emrat, vjen propozimi I kryetarit dhe votohet pako te dy emrat e votuan një nga një dhe po ashtu edhe propozimi I kryetarit dhe del vendimi për te tre emrat. Kjo është procedurë e rregullt demokratike dhe që është praktikë edhe ne kuvendin e republikës se Kosovës. Kështu që nëse kjo nuk është e lejueshme atëherë le te del dikush dhe te thotë se me këtë nenë te kësaj rregullore se vetëm votohet si pako atëherë unë pajtohem plotësisht edhe shkojmë e votojmë si pako.

Isak Hoti – Bazë kryesore e secilit kuvend komunal e kemi udhëzimin administrativ për KPF edhe komitetet e përhershme dhe aty e specifikon qartë. Kështu që ne nuk mundemi ne secilin udhëzim apo ne secilin ligje nuk parashihet diçka që ju po e kërkon. KPF-ja përcakton mbi bazën e fuqisë politike e ulëseve ne kuvend atëherë përcaktohen edhe propozimet. Dhe tash nëse i kemi dy propozime ne kuvend dhe i kemi katër subjekte politike atëherë si donë me funksionue kështu. Këto praktika nuk janë praktika te mira, kështu që ju kisha sugjerue që me marr udhëzimin e KPF-së për komitetet e përhershme dhe aty e

përcakton pasi janë bazë e secilit vendim që formohen komisionet për me i shtyje përpara edhe vendimet tjera, pasi nuk mundesh me dal jashtë asaj që nuk është përcaktuar dhe sigurisht se ka gjëra edhe që nuk shkruhen. Nuk mundet ligji për ndërmarrjet publike me thanë se qysh duhet me u votua, pasi nuk e përcakton këtë.

Burim Krasniqi – Secili anëtar i komisionit me përjashtim ku është e precizuar zgjidhet ai që merr shumicën e votave e jo ai që ka përfaqësim me te madh te votave.

Isak Hoti – Asnjëra prej partive politike nuk është e shkruar aty sepse ne udhëzim administrativ për komitete e përhershme është bazë për secilin komision që formohet dhe vazhdimisht ju them se nuk duhet harruar kuotën e gjinisë femërore. Këtu e kemi asamblistin e me te vjetër Rasim Fazliu që e din shume mirë se si ka funksionuar dhe si funksionon kjo, gjithashtu edhe unë kam mandatin e katërt tani që punoj që realisht nuk ka ndodhur e nuk do të ndodh dhe pikërisht i sugjerova edhe kryesuesit që me pas kujdes ne shkelje që bëhen pasi që ka pasojat rreth kësaj.

Rasim Fazliu – Përshëndetje për ju kryesues, kryetarin e komunës, nënkryetarin, anëtarët e kuvendit komunal, drejtorët e drejtorive, përfaqësues të mediave dhe gjithë te pranishmit ne sallë. Unë deshta pak me kontribuuu ne këtë pikë te rendit te ditës, unë mendoj se është një çasje e gabuar sepse te gjitha subjektet politike që janë ne kuvend kanë te drejtë te propozojnë kandidatin e tyre ne komision pasi nuk do te thotë që kërkohen vetëm dy kandidat por mund te propozohen edhe me shume se dy kandidat dhe me pastaj për te gjithë[ata kandidat behet votimi dhe dy prej kandidateve që marrin vota me shume atëherë zgjedhën anëtar te komisionit. Kjo është praktika dhe kështu duhet me ndjek, pasi nuk kemi nevojë me shkua me vetëm me dy kandidat pasi mundemi me pas edhe me shume e me pastaj kuvendi është ai që cakton se cilët kandidat shkojnë për anëtar te komisionit përmes votave që i jepen atij kandidati.

Besë Bytyqi – E dëgjuam edhe zyrtarin se çka ka për te thënë për këto komisione, por ne titullin e kësaj pike shkruan shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për formimin e komisionit d.m.th. jo te anëtarëve veç e veç, gjithashtu zyrtari ligjore e din shume mirë legjislacionin e qeverisë[lokale, kështu që unë konsideroj se duhet te ndjekim udhëzimin e zyrtarit ligjor dhe te votojmë ne pako.

Sinan Kryeziu – Faleminderit kryesues, përshëndetje për te gjithë. Ne si lëvizje Vetëvendosje jemi që te shkojmë veç e veç ne votim për faktin se e mbështes edhe parafolësin, nuk mundemi ne këtu nëse përfaqësuesi ligjor i komunës nuk na jep decidivisht udhëzime prej ligjit, ky e tha po e citoj si praktikë dhe sigurisht se praktikat normal ndryshohen pasi janë rregulla te pashkruara dhe sigurisht që edhe ndryshohen sa here që është nevoja. Ne mendojmë se duhet te votohet veç e veç pasi je legjitim kur votohet veç e veç, kështu që ne pako ndoshta ne si vetëvendosje mundemi mos me marr votë te mjaftueshme dhe jemi jo legjitim ashtu, kështu që qëndrimi jonë është te votohet veç e veç.

Bejtullah Deliu – Mendoj që edhe ne jemi te mendimit dhe pajtohemi me parafolësit që te votohet veç e veç pasi nuk ka ndonjë specifike ligjore që e përcakton këtë, kështu që ne jemi kuvendarë dhe mundemi secili me votën e lirë që me votua për kandidatin që mendojmë se duhet me na përfaqësua.

Isak Hoti – Ne çdo fillim mandat ne i sjellim dy komitete që janë te përhershme që unë e konsideroj që është bazë për themelimin e te gjitha komisioneve tjera. Neni 5 pika 2, etnitetet politike me numrin me te madhe te vendeve varësisht nga përqindja e përfaqësimit ne kuvend do te përfaqësohen edhe ne komitet. Pra bazë për komisionet është ky udhëzim administrativ, kështu që ju merrni edhe përgjegjësit edhe gjithashtu edhe pjesët tjera dhe nënshkrues i vendimit është kryesuesi.

Kryetari - Unë nuk po dua me hije ne çështje procedurale por fakti që ka një koalicion te opozitës atëherë sikur te isha ne vend te juajin ne secilin komision e kisha shtie ka një person te secilës prej partive politike. Pra ne kuvend te komunës ka opozitë te bashkuar dhe pozitë. Unë mendoj që realisht dhe politikisht bazuar që grupi me i madhe politik ka asetet e veta ne cilin do proces por do te ishte shume e mirë dhe e

shëndetshme nëse dëshirojmë me ruajt këtë format pra pozitë dhe opozitë që do të ishte mirë në çdo komision me pas edhe te pozitës edhe te opozitës. Unë mendoj që aq shumë punë në kuvendin e komunës së Rahovecit sa gjithkush ka me pas mundësi me dhanë kontributin e vet gjithkush dhe po besoj që nuk kemi anëtar sa ke me pas komisione apo vendime të ndryshme. Kështu që unë në cilësinë e kryetarit të komunës që të keni mirëkuptim, pasi meqenëse është grupi politik mos të humbim kohë dhe me i lanë mundësi vetes që me operua në mënyrë me të suksesshme pasi janë me dhjetëra komisione vetëm në këtë rend ditë që jemi të obligueshme me i bo, po ashtu në muajin mars kemi me bo përsëri komisione të tjera të cilat gjithsesi kanë me u përfshijë anëtarët e pozitës dhe te opozitës, kështu që mos këmbëngulni në diçka që shumë e rëndësishme është me ecë proceset përpara, pasi ju e dini edhe në këto komisione roli i kryetarit të komunës dhe i ekzekutivit të komunës në çdo proces është shumë i madhe. Pra keni me punua me neve kushdo që bëhet por mos këmbëngulni në diçka që është e panevojshme dhe e paarsyeshme pasi megjithatë ju jeni përfaqësues të zgjedhur dhe nuk duhet të kapeni shumë në procedura pasi zyra ligjore është ajo që duhet të kapet pasi në jemi përfaqësues të popullit të komunës së Rahovecit. Kështu që ata që dëshirojnë me u marr me aktivitete politike publike i kuptojnë këto e sidomos i kupton Burimi Bejtullahu e po ashtu edhe Defrimi që është kryesues tash dhe që është djallë me perspektiv për të ardhmen dhe sigurisht se duhet ta kuptojmë secili se jemi të zgjedhur sepse duke u marr me procedura që me frenua diçka që është e paarsyeshme p.sh. nëse në një komision të caktuar janë përshijë AAK-ja dhe LDK-ja por në komisionin tjetër mundet me u përshijë VV-ja apo PDK-ja, kështu që nuk besoj që ka me pas vend me shpreh pakënaqësi pasi në fund në të gjitha këto procese ndikimi i kryetarit si institucion është shumë i madhe sikur që është edhe i kuvendit. Kështu që ju kisha ftuar edhe njëherë që mos të bëheni pjese e debateve të cilat nuk prodhojnë asgjë, pasi kur jemi të praktikuar në mund të përdorim praktika pasi kuvendi i komunës mundet me vendos për shumëçka por nuk duhet të stopohen proceset pasi në presim përgjigje edhe prej MAPL-së nga departamenti i ligjeve që të mos të detyrohemi edhe njëherë pasi siç e dini se çdo seancë monitorohet nga një përfaqësues i ministrisë së pushtetit lokal. Pra vendimmarrja kanjeherë duhet me qenë edhe saktë, që ndoshta edhe mund të këtë praktika siç e përmendi Burimi me herët në kuvendin e Kosovës por zakonisht nuk duhet me bo luftë për asgjë. Kështu që me një mini ekspertizë ka vendos drejtori i caktuar që Burim Krasniqi me kontribuu sepse neve na duhet ekspertiza në shërbim të komunitetit. Pra duke u kapur për procedura nuk duhet të vonojmë proceset dhe nuk keni nevojë me u shqetësua askush sepse krejt në fund cilido komision ka me pas punë me ekzekutivin dhe ju e dini që në instancën e fundit prap kryetari i komunës është në njëfarë pozicioni kur ka bllokime apo vonesa merret me zhblokimin e tyre. Kështu që komisioni i aksioneve por edhe komisione tjera prapë pa i ardh lënda të kryetari i komunës nëse ka probleme . Po ashtu ju e dini se kryetari i komunës ka mundësi edhe me i anulua konkurset, pra mos me shtini që me u përkushtua deri në fund sepse nuk i del mirë asnjë partie politike, pasi mbi të gjitha jam kryetar i komunës dhe dinamika e punës tonë po rritet dhe gjithashtu e komunës po rritet dhe sigurisht se ka me pas plot sene që nuk kanë qenë në mandatin e kaluar sepse shumë kush ka me pas mundësi me pae veten të përfshirë në vendimmarrje edhe në aktivitete jashtë kuvendit të komunës.

Sinan Kryeziu – Pa dashtë me u ndërlik këtu por me imponohet pasi e di që ky kuvend komunal që ekziston për faktin se ka qëndrime dhe diversitete të ndryshme të mendimeve dhe qëndrimeve. Mendoj se kryetari është në kontradiktë me shëfën e grupit të AAK-së për faktin se kur kjo e mori fjalën tha si grupi me i madhe parlamentar në asamble kurse kryetari e merr fjalën pas saj dhe thotë se ju keni koalicion, që i bien se kundërshtohet mendimi i saj dhe nëse kemi në koalicion atëherë jemi 3 me 1 dhe këtë sapo e tha kryetari, kështu që nëse kemi koalicion atëherë në jemi shumica dhe nuk është kryetari shumica. Kështu që krejt çka di me thanë është se në kemi mendime dhe qëndrime të kundërta dhe shumica vendos dhe në këtë

rast shumicë është opozita pavarësisht a kemi koalicion te shkruar apo te pashkruar dhe ne do rrimë kështu si jemi.

Sejfullah Sejfullahu – Përshëndetje kryesues, kryetar, kuvendare, media dhe gjithë te pranishëm ne sallë. E shoh që po diskutohet shume dhe po merret shume kohë dhe nëse kërkohen vetëm dy anëtar që u propozuan ne pako atëherë pse nuk e qesim ne votim dhe te kalojmë ne tjera pika pasi vërtet kështu si veprohet është jo demokratike.

Rasim Fazliu – Unë propozoj që te bëjmë një pauzë se paku 10 minute për konsultime ,pasi e shoh që nuk po shkon ashtut si duhet dhe pas konsultimeve te rifillojmë përsëri mbledhjen.

Kryesuesi – Atëherë shkojmë për një pauzë 10 minuta dhe kthehemi përsëri ne seancë.

Për korrektsinë tuaj po e vendosi ne votim çështjen dhe mënyrën qysh kemi vendos për anëtarët ne këto komisione. Pas konsultimit që kishim, një mënyrë që e ka propozua kryetari që dy anëtar nga kuvendi komunal kanë me përmbush komisionin komunal te aksionareve, gjithashtu edhe një propozim tjetër ka ardh edhe nga z.Burim Krasniqi që secili grup i asamblistëve që propozon atëherë çdo emër i propozuar te votohet dhe kështu te përmbushen këto dy vende ne komisionin komunal te aksionareve.

Besë Bytyqi – Atëherë dua me përsërit edhe njëherë fjalën që e kam thënë paraprakisht, që zyrtari ligjor z. Isak Hoti e dinë me se miri ligjin për vetëqeverisje lokale po ashtu ne gjate kohës se diskutimit e lexuam pak a shume pasi nuk kemi pasur mundësi edhe me u përfshije me detaisht, kështu që nuk e di a po dojmë me i shkelë rregulloret udhëzimet apo çka po dojmë me bo ne këtë kuvend, Nuk jam për me shkelë asnjë rregullore dhe asnjë udhëzim kështu që nëse ligji e thotë që duhet me u votue ne pako atëherë e konsideroj që te gjithë koleget e mi që pak a shume e kanë te njohur ligjin nuk dëshirojnë me shkel dhe nuk dojnë me votue ne te njëjtën formë.

Hasan Përboqi – Përshëndetje kryetar, kryesues, kolegë asamblistë, drejtor te drejtorive ,media te pranishme. Edhe pse deshta me kursye kohen dhe mos me marr fjalën, për arsye se po atakohet direkt emri im aty pop rune kam një propozim që ti dëgjojmë se pari te gjithë shefat e asamblistëve që janë[këtu se ndoshta prej te gjithë grupeve te asamblistë vetëm një propozim del atëherë bëhen dy dhe shkojmë ne pako ne votim. Atëherë ne këtë rast jam vetëm unë i propozuar me shkua direkt ne votim dhe nëse ka vetëm një emër prej opozitës, pse me shkua kështu votimet e ndara por me shkua votimet ne pako. Kështu që për fillim kisha propozue me i dëgjuat shefat e grupeve që me propozua secili emrin e vet dhe pastaj shohim që nëse ka me shume se dy propozime mundemi me shkue ne votime te veçantë dhe nëse mbetet vetëm një propozim prej komplet opozitës atëherë votohet ne pako sepse vetëm dy anëtar jemi.

Besa Bytyqi – Konsideroj se ju duhet që ta mbani rregullin ne këtë seancë dhe me kërkua nga secili shef i grupit propozime rreth emrit ashtu siç ma kërkove mua nga grupi i aleancës, kështu që duhet se pari emrat dhe ne vendosim bashkërisht nëse dëshirojmë ne votim, pasi nuk duhet krijojmë ndasi sepse nuk do te ishte ne rregull.

Kryetari – Meqenëse po flasim për praktika nuk do ishte ne rregull që një shefi te një grupi politik me i kërkua propozim apo emër konkret ndërsa tre shefave tjerë te grupeve politike mos me ju kërkua emrin konkret, kështu që me përgjegjësi e them se kjo nuk është praktikë. Besoj që kryesuesi duhet me qenë me i qartë ne udhëheqjen e seancës se mbledhjes dhe duhet me kërkua emra konkret prej shefave te grupeve politike te përfaqësuar ne kuvend ashtu siç e ka kërkuar nga grupi i aleancës. Kështu që me shume respekt ju drejtohem kryesues, se nuk mundeni me qit ne lajthitje një grup politik edhe me i kursye grupet tjera politike. Por nëse nuk kanë emra atëherë me pastaj ju mund ta qitni formën e votimit.

Rasim Fazliu – i nderuari kryesues, para se me dal ne pauzë propozova që edhe ajo po kërkohet vazhdimisht, që grupet politike e japin emrin te gjitha atë që dëshirojnë dhe me pastaj dakordohemi për çështjen e formës se votimit. Pra le ti japin propozimet njëherë dhe me pastaj votojmë pasi nuk ka nevojë

me krijua bllokada te panevojshme, secili grup politik duhet te propozon një emër që mundet edhe me pas ndonjë grup politik që nuk dëshiron me propozua asnjë emër për anëtar te komisionit dhe nuk mundet askush me ja imponua.

Shqipe KRYEZIU – Fillimisht kërkoj nga ju kryesues, që mos na diskrimino opozita dhe pozita, pasi i japim dy emra ,pasi nga pozita u dha emri kurse edhe opozita duhet merren vesh që ta japin një emër edhe e qesim ne votim. Kështu që si kuvendarë nuk kemi nevojë me na diskriminua që dikush me dhanë emër e dikush mos me dhanë dhe ju duhet te mbani rregull dhe vetëm punën tuaj ta bëni.

Artan Asllani – Përshëndetje për te gjithë. I nderuar kryesues, me gjithë respektin që kam për ty dhe për te gjithë te tjerët, krejt këtë tollovi ju po e bëni. Ju po citoni që i respektoj te gjithë mirëpo paraprakisht nuk e respektoni rregulloren e kuvendit sa i përket dhënies se fjalës. Kështu që te gjithë shefat e grupeve parlamentare duhet te propozojnë nga një emër dhe ne si aleancë e kemi propozuar dhe e qesim ne votim.

Leonard Morina – Propozimi i grupit te Vetëvendosjes është Sinan Kryeziu.

Burim Krasniqi – Grupi i LDK-së nuk ka asnjë te propozuar.

Bejtullah Deliu – Grupi i PDK-së e ka te propozuar Sejfullah Sejfullahu.

Kryesuesi- Atëherë kemi tre emra te propozuar për komisionin komunal te aksionareve për ndërmarrjen KRM. Ekoregjioni. Tani po vendosim për mënyrën e votimit te emrave dhe propozimi i Rasim Fazliut ishte që votimi te shkon për secilin emër veç e veç dhe ai që merr me shume vota emërohet anëtar i komisionit komunal te aksionareve. A jeni për propozimin e z. Fazliu për mënyrën e votimit. Me 15 vota për, 12 kundër asnjë abstenim kalon propozimi i zotit Rasim Fazliu për mënyrën e votimit për zgjedhjen e komisionit komunal te aksionareve.

Isak Hoti – Rregullorja e punës se kuvendit thotë se kur duhet te zgjidhet apo te emërohet ndonjë anëtar për ndonjë funksion apo pozitë ne komunë dhe kur për këtë ekzistojnë dy apo me shume propozime atëherë emir te propozuarve shënohet ne liste sipas renditjes se alfabetit te mbiemrave te tyre. Votimi behet ashtu që ne fletëvotim shënohet me shkronjën x dhe kur kemi me shume se një te propozuar atëherë shkohet me votim te mfshehtë. Afër emrit te kandidatit te cilit kandidat dëshiron te votoj duke hedhur fletëvotimin ne kutin e caktuar për votim.

Kryesuesi – Unë kisha kërkuar edhe një sqarim nga zyrtari ligjor, pasi kuvendi komunal mundet me vendos ndryshe për çështje e votimit për çështje te ndryshme, qoftë prej rregullores apo prej ligjit për vetëqeverisje lokale.

Isak Hoti – I nderuari kryesues, duhet ta lexoni 64 te rregullores se kuvendit ku thotë se nëse keni me shume se dy propozime pasi definon qartë atëherë shkon ne mënyrën e fshehtë te votimit .

Kryesuesi – Atëherë po e citoj te çështja e votimit rregullorja e punës se kuvendit te neni 61 pika 2 ku thotë se kuvendi mund te deklarohet për formën e votimit kur ka mundësi te zgjedhjes d.m.th. mundësi te zgjedhjes janë këta tre emra që i kanë propozua grupet e asamblastëve, kështu që po besoj që kuvendi komunal e ka te drejtën me vendos për mënyrën e votimit.

Isak Hoti – Propozimet u dhanë nga tri parti politike dhe ai propozim duhet te del ne votim pasi ju i bëtë propozimet por sikur mos te kishe bo propozimet e keni shume mirë te specifikuar mënyrën e votimit dhe nuk ka mundësi tash, pasi nuk mund te merren dy vendime për te njëjtën çështje.

Afrim Berisha – Përshëndetje kryesues, i nderuar kryetar i komunës, drejtor te drejtorive, kolege asamblastë. Mendoj se kjo çështje është e lehtë dhe nuk ka nevojë me u diskutua gjatë, pasi nga nga katër grupet e partive politike u dhanë propozimet. Gjithashtu zyrtari ligjor e potencoj shume mirë se si duhet te shkojhet ligjërisht ne bazë te rregullores, kështu që ne deklarohemi për unitet kurse ne realitet nuk e tregojmë këtë . Pra duhet me gjet një konsensus te përbashkët me gjet një[zgjidhje dhe jo me u vonua na edhe me bllokua proceset.

Burim Krasniqi – Rregullorja e punës së kuvendit edhe ligji për vetëqeverisje lokale e len të hapur formën e votimit me përcaktua kuvendi komunal me votim me votim të hapur apo të fshehtë.

Kryesuesi – Atëherë pas shumë këtyre paqartësive, unë po besoj që kuvendi komunal e ka fuqinë që të vendos edhe për formën e votimit dhe autoriteti mbikëqyrës në këtë rast MAPL-ja mundet me kthye vendimin nëse nuk është në rregull me aktet nënligjore.

Kryetari – Të nderuar asamblistë, a jeni për komunë transparente apo jo, a jeni për komunë me performancë apo jo, ju duhet ta dini se çdo vendim që kthehet nga MAPL-ja regjistrohet dhe për këtë nuk jam fajtor unë që plot nga asamblistë nuk e kanë të qartë këtë situatën. Është e papranueshme logjika e udhëheqjes së mbledhjes nga ana e kryesuesit, pasi unë jam kryetar i qytetareve të komunës i zgjedhur nga shumica me 65,32 % dhe nuk jam i interesuar me pas mungesë transparence sepse çdo vendim që kthehet nga cilido organ qoftë e sidomos nga MAPL-ja regjistrohet. Prandaj dua prononcim nga Burim Krasniqi në emër të LDK-së a duhet me shkua me kete logjike përpara, po ashtu kërkoj qëndrim edhe nga Bejtullah Deliu nga PDK-ja, nga Besmire Bytyqi nga AAK-ja dhe nga Leonard Morina nga VV-ja. Pra duhet ta kuptoni dhe ta keni të qartë se jemi të paret në nivel nacional sa i përket transparencës pastaj jemi të dytë në performancë dhe gjithashtu duhet që ta kuptoni se çdo vendim që kthehet edhe kërkohet me u shfuqizua edhe njëherë regjistrohet kështu që të gjitha janë poena. Pra nëse ju keni marr përsipër me vazhdua me këtë logjikë në emër të një lloje opozitarizmi të paqartë dhe të pabazë të pa koncept duke krijuar praktika të cilat janë të panevojshme. Tash nuk ka me rëndësi se kush po behet anëtar i komisionit komunal të aksionareve qoftë për Ekoregjon qoftë për stacion të autobusëve. Kështu që ju kisha lutur që me marr pak me qetësi mos bëni veprime që nuk i ndihmojnë komunës se juaj e as juve si të zgjedhur nga populli pasi qytetari ynë pret diçka tjetër nga komuna e Rahovecit dhe nga kuvendi i komunës së Rahovecit dhe jo me bllokua në çështje të procedurave të pakuptimta. Pra kryesuesit të kuvendit i jap rast që të përmirësua pozicionin e tij në komentime dhe me qenë i përmbajtur pasi ka rregulloren e punës dhe duhet ta dinë se rregullorja e punës së kuvendit nuk ndërrohet çdo ditë. Kështu që nëse ne, në rastin konkret i kemi 3 emra dhe votimi është pashmangshëm por çfarë votimi i hapur apo i fshehtë. Dikush thotë që kuvendi duhet me u deklarua kuvendi për mënyrën e votimit. Por unë mendoj që kryetari i komunës por edhe secili prej jush e dini që në rastet e tilla hyhet në votim të fshehtë ska rëndësi rezultati pasi që janë me shumë se dy emra. Kështu që ju them që mos humbni kohë me shumë pasi nuk duhet të bëni veprime që ju mendojnë që për momentin ju ndihmojnë por janë veprime që përkohësisht ju ndihmon pasi nëse në MAPL-ja e kthen vendimin atëherë duhet ta dini se përgjegjësinë e mbani direkt ju si kuvend i komunës. Kështu që edhe unë di me fol me qytetarët pasi ju po mundoheni me krijua kushte kundër një grupi politik që është me i madhi në kuvend dhe qytetarët e dinë këtë pasi janë 13 anëtar të një grupi politik dhe po tentoni me bo veprime të pakuptimta në emër të procedurave dhe praktika që vetëm Burim Krasniqi din me i krijua këto, por nuk duhet ta harroni se në politike ka edhe ngritje edhe ulje, pasi për gjithë këto bllokime që po tentohet të krijohen nuk është shkaktar kryesuesi pasi vazhdimisht e ka shikimin dhe mimikën e Burim Krasniqit, Bejtullah Deliu dhe Leonard Morines. Kështu që edhe njëherë ju them që nuk duhet të kapeni për procedura se sa me të rëndësishme se sa procedurat duhet me ofrua zgjidhje. Po ashtu dua të potencoj që kryetarit të komunës nuk ka të drejtë me ja mohua të drejtën e fjalës asnjëherë dhe ka të drejtë në çdo minutë me marr fjalën dhe vazhdimisht me bo komente. Por kryesuesi i kuvendit të komunës duhet të jetë i përmbajtur në komente sepse ai është udhëheqës i seancës dhe kryetari i komunës ka të drejtë të rezervuar me marr fjalën sa herë që e vlerëson që duhet me marr fjalën.

Kryesuesi – Unë dua të potencoj se në ligjin për vetëqeverisje lokale e shoh një nenë që në bazë të cilit funksionon edhe komuna e Rahovecit por edhe kuvendi komunal, ku nëni 48 i ligjit për vetëqeverisje lokale të çështja e votimit pika 48.2 thotë qartë se nëse ndryshe nuk parashihet shprehimisht në këtë ligj

vendimet e kuvendit te komunës aprovohen me shumicën e anëtareve që janë te pranishëm dhe që votojnë. Kështu që do te ishte mirë edhe zyrtari ligjor me dhanë një koment rreth këtij neni te ligjit për vetëqeverisje lokale.

Burim Krasniqi – Unë po besoj që me se pari duhet plotësim ndryshimin e rregullores që me përcaktua sa ka te drejt me fol rreth minutazhes pastaj është seanca e dytë dhe serish sjellja e njëjte nga kryetari. Nuk jam këtu për me mbështjell por jam këtu për me luftë rolin tem, pasi mi than dikujt se po mbështjell është e pandershme pasi një kryetar komune përfaqëson qytetaret e komunës se Rahovecit dhe nuk përfaqëson një grup politik pasi është vullneti i qytetareve që ju kanë zgjedh. Asnjëri nga ne këtu nuk jemi me vullnetin e askujt por me votën e qytetareve. Nëse mendoni se ju jeni legjitim dhe ne jemi jo legjitim atëherë me duhet te ju them se e keni shume gabim. Kështu që është e papranueshme dhe e pa tolerueshme që me dal edhe me than se po përshtjelli. Për karrierën temë politike e di unë dhe e din secili, kështu që ju nuk duhet te brengoseni se a ngritëm apo ulem politikisht, pasi është çështje ekskluzive e jema personale dhe e subjektit temë që a me lejojnë me shkua tutje apo nuk me lejojnë. Kështu që kërkoj mirëkuptimin pasi kur flasim për një pikë te rendit te ditës, nuk nevojë për çdo pikë te rendit te ditës me dal me interpretua mua politikisht apo tjerët apo me dhanë vlerësime që sa dimë apo kemi përvojë apo nuk kemi. Ne duhet te flasim për pikën e rendit te ditës, a pajtohemi apo s’pajtohemi shkojmë tutje. Për mua është e papranueshme që kryetari me lejua me ofendua asamblenë komunale sepse nesër mundet me ardh një kryetar tjetër edhe me i thanë dikujt tjetër. Po ashtu kërkoj edhe nga grupi i aleancës kërkoj mirëkuptimin. Kështu që paralajmëroj se sa here ka me pas ofendime ne drejtim te asamblesë komunale atëherë grupi i LDK-së nuk do te qëndron ne seancë dhe do te behet praktike kjo çështje. Nëse thuhet që ne momentin që kthehet prej MAPL-së që kemi bërë shkelje ligjore edhe e mban përgjegjësin asambleja. Por çka ndodh nëse nuk kthehet prej MAPL-së atëherë kush e mban përgjegjësin, a ka tentua dikush me mashtrua asamblenë sikur për komitetet thoshin që nuk është ne rregull mirëpo doli që gjithçka është ne rregull.

Kryetari- E para Komiteti për Politike dhe Financa është një komitet i paprecedentë, pasi ka një përzierje ne kuptimin e përfaqësimit politik, pastaj ju e dini se kryetari i komunës sipas ligjit mos me ju sjellë material ju shkoni te shpija krejt edhe shkoni ne zgjedhje. Ndërsa sa i përket fyerjeve atëherë mos e fyeri kuvendin e komunës dhe qytetaret pasi asnjëherë nuk e kam fye kuvendin e komunës dhe ne çdo seancë kam marr pjesë dhe kjo është e paraqitur edhe ne raportin e performances madje ne gatishmërinë e plotë se unë jam 24 ore jam ne shërbim edhe te juajin. Tash nëse mendon një grup politik që e ka ekskluzivitetin atëherë e ka gabim, pasi dikush deshiron me shfaq mendime personale atëherë mundet me shfaq sepse është e drejtë e secilit por kurrkush se ka ekskluzivitetin, pasi ekskluzivitetin e ka kuvendi i komunës se Rahovecit. Por sjellja sikur nuk po i kuptojmë këto situata, sigurisht se këto i kuptoj këto situata dhe këtë ju kam thënë edhe ne takimin e kaluar që dilni dhe bëni publike marrëveshjen që keni mes vete te tri partitë politike, duhet ta bëni publike pasi do te ishte mirë edhe për hir te transparencës ne raport me qytetaret e komunës se Rahovecit. Duhet ta dini që me këto veprime dhe marrëveshje te juaja që edhe kemi edhe s’kemi marrëveshje nuk do ti bëni nder qytetarëve që ju kanë zgjedhur dhe sigurisht as unë nuk do ju bëja nder nëse kisha vepruar kështu. Unë nuk jam duke mbrojtur një subjekt politik, pasi unë nuk po e them se aleanca duhet me i pas anëtarët ne këto komisione pasi kjo është punë e kuvendit dhe kuvendi duhet me vendos por me praktika mos te mundohet me luajt te mençurin si njohës i mirë i situatave ligjore që mos te bohet sikur s’po dimë asgjë. Kështu që ju duhet ti ndjekin procedurat por nëse ka me shume se dy kandidat atëherë do te ishte mirë me hije ne votim te fshehtë pasi arsyeja pse nuk votohet ne mënyrë te hapur është se praktikat institucionale edhe parlamentare edhe te kuvendeve te komunave duhet që ti respektojmë ndërsa sa i takon rregullores edhe njëherë po e them se nëse ju e keni përcaktua sa kemi me fol atëherë ju them se kryetari i komunës e ka te drejtën çdo minutë me fol dhe ju këtë e dini. Kështu që ju kisha lut që ta respektoni ju

rregulloren e komunës por edhe nëse doni me ndryshua mundeni me rrit minutazhin se për nuk do te ishte aspak problem. Por nuk duhet të harroni se këto praktika dhe ngatërresa te pakuptimta nuk i bëjnë nder askujt e me se paku qytetareve dhe nëse mendoni që unë jam arrogant pasi them se i kam mbi 65% atëherë e keni gabim pasi sikur te kisha shpreh arrogancë atëherë nuk kisha ardhë hiq ne mbledhje te kuvendit asnjëherë, kështu që ju e dini se ju respektoj dhe kjo është arsyeja se vij ne mbledhje te kuvendit dhe gjithashtu edhe raportet me qesin mirë por nëse doni me debatua qartë edhe për situata që janë me respekt dhe me interes te publikut atëherë edhe mund te debatojmë. Por nëse doni me bo makinacione që ju jeni te gjitha grupet politike dhe boni si te doni sepse nuk kam kohë merrem me juve hiq për procedura pa lidhje. Pasi ka një praktike dhe praktikat e mira dhe pozitive duhet me i respektua te gjithë, kështu që nëse edhe njëherë po mendoni që ju duhet vazhdoni te bëni këso sjellje dhe doni me dal jashtë seance mundeni pasi kërkush askënd nuk mundet me zor me sjell ne mbledhje por duhet ta dini se qytetaret ju kanë zgjedhur që ju me qëndrua këtu që me pas qëndrime konstruktive që me i përfaqësua dhe me i mbrojte interesat e tyre. Kështu që duhet ta dini se kryetari i komunës nuk bën tërheqja asnjëherë kur ka te bëjë me interesat e qytetareve dhe duhet ta dini se nuk mundeni me i krijua vështirësi kryetarit te komunës pasi kryetari i komunës është i zgjedhuri i popullit sepse është institucion legal ashtu siç është edhe institucioni i kuvendit ka besueshmëri te lartë dhe është i zgjedhur ashtu siç jeni edhe ju te zgjedhur. Me ligjin për vetëqeverisje lokale nuk mundeni asnjë kryetar te komunës me bllokua ne proceset e tij pasi e ka rregullua çështjen e kryetarit dhe te kuvendit por edhe mandati e obligon kryetarin pasi institucioni i kryetarit te komunës është institucion legal dhe nuk pranon me logjikën e shantazhit dhe as te imponimit pasi deri me tani vetëm mirë i kam bërë këtij vendi dhe te vazhdoj te i bëj mirë pasi nuk kam asnjë akuzë përveç tribunalit te Hagës.

Rasim Fazliu – Faleminderit shume kryesues, unë mendoj se krejt kjo zhegitje e kësaj mbledhje është plotësisht e panevojshme sepse rrugën e kemi te hapur dhe ne vet po bëjmë zhurmë te panevojshme te gjithë ne përgjithësi, pasi zyrtari e tha qartë po ashtu ju si kryesues e cituat qartë, grupet politike I dhanë propozimet e veta siç e tha edhe anëtari I AAL-së dhe që e mbështes dhe tash nuk e di pse po flasim diçka që është jashtë kësaj çështje. Kështu që janë dy mundësi, mundësia e pare është me votua me vota te hapura për kandidatet që u propozuan nga grupet politike dhe kush merr vota me shume atëherë shkon. Pastaj mundësia e dytë sekretariati i përgatit fletëvotimet me lista te mbyllura edhe votojmë. Kështu që nuk kemi nevojë me shkua edhe me bllokua procedurën ashtu siç jemi duke vepruar deri me tash, gjithashtu e mbështes edhe atë që e tha kryetari se duhet me tregua se jemi komunë e mirë dhe transparente mirëpo edhe kryetarit do ti them se do te ishte mirë që legjislativin me lanë me krye punën e vet, pra krejt normale oshtë që kryetari me respektua legjislativin pasi jemi pushtete te ndara. Këtu kemi shume asamblistë nga legjislatura e kaluar e po ashtu edhe ish kryesuesin pasi pikërisht ne legjislaturën e kaluar kemi pasur raste kur ka pasur propozime me shume se sa duhet edhe e kemi bërë me ngritje te dorës dhe kemi shtyje proceset përpara por nëse nuk dojmë ashtu atëherë është mundësia e dytë me lista te mbyllura. Kështu që nuk kemi nevojë me humb kohë pasi te gjithë jemi këtu për me i mbrojte interesat e qytetareve, kështu që unë jam përafrim te qëndrimeve dhe me vazhdua puna e mbarë e mirë, kështu që i nderuari kryesues ju propozoj që te vazhdoni te qitni me vota te hapura dhe nëse dikush nuk pajtohet atëherë e lus sekretarinë te përgatisë fletëvotimet e me pastaj votojmë shkojmë përpara. Faleminderit për mirëkuptimin tuaj.

Kryesuesi – Gjithashtu edhe unë mendoj se te gjithë këtu që jemi nuk kemi qëllime te këqija apo stopimin e punëve qoftë te kuvendit apo te ekzekutivit pasi secili jemi këtu te përfaqësuar prej qytetareve dhe po mundohemi me bo me te mirën për ta. Te kjo çështje duke u bazuar ne nenin 48 te ligjit për vetëqeverisje lokale te çështja e votimit pika 48.2 nëse ndryshe nuk parashihet ndryshe ne këtë ligjë, vendimet e kuvendit te komunës aprovohen me shumicën e anëtareve që janë te pranishëm dhe që votojnë. Kështu që ne vetëm e

kaluam propozimin e z. Rasim Fazliu për votimin e secilit të propozuarve të grupeve të asamblistëve veç e veç.

Kryetari – Unë jam dakord me atë që e tha z. Rasim Fazliu pasi shihet që ka përvojë për këtë, pasi si e kuptova unë vetëm një këshilltar me kërkua se dojmë votim të fshehtë atëherë duhet me shkua me votim të fshehtë mirëpo nëse nuk ka reagime prej askujt atëherë mundemi me shkua me votim me lista të hapura. Pra nëse një parti politike e konsideron se dëshirojmë me hije në votim të fshehtë atëherë duhet me qenë respekti me i lartë dhe me i ndërsjellët në kuptimin e koordinimit dhe të bashkëveprimit brenda kuvendit.

Besë Bytyqi – Para se me shkua në votim që a jemi kundër apo pro, pasi është për të disatën herë që po ndodhë dhe i tejkalojmë gjërat pa vetëdijen tonë por duhet me na respektua që me ju respektua. Kështu si grup i aleancës për ardhmërinë e Kosovës e konsiderojmë se jemi të gatshëm me vazhdua deri vone edhe me vazhdua me votim të fshehtë sepse nuk lodhemi edhe dëshirojmë me punua për qytetaret edhe jemi këtu për transparencë dhe llogaridhënie për qytetaret, kështu që vazhdojmë me votim të fshehtë.

Rumit Zhuniqi – Faleminderit kryesues, unë jam që kjo me shkua me votim të fshehtë pasi shume me demokratike është vota e fshehtë dhe po ashtu testohet edhe besnikëria e koalicionit të juaj pasi nuk e di pse nuk po i besoni njeri tjetrit me votë të fshehtë.

Bejtullah Deliu – Faleminderit kryesues, i dëgjova parafolësit edhe me herët e gjithashtu edhe kryetarin që kohë pas kohë mundohet të tregoj se duhet një politik ndryshe me përcjell apo me udhëheq, pasi a ka marrëveshje apo nuk ka pa marrë parasysh në kemi vendos, pasi në jemi edhe ta pavarur secili këtu me vendos individualisht, por nëse dëshirojmë me u thirr në demokraci atëherë pse po kërkojmë të shkojmë me votim të fshehtë, pasi thuani në demokraci atëherë shkojmë me votim të hapur me ngritje të dorës dhe secili voton sipas dëshirës së tij dhe nuk kemi nevojë me u fsheh pasi jemi në interesin e qytetareve.

Kryesuesi – Atëherë për hir të respektit për secilin anëtar të kuvendit komunal edhe këtë çështje po e vendosim në votim ku me shumicë votash që po besoj që nuk ka respekt me të madh se fuqia që na garanton një ulëse në kuvendin komunal. Atëherë po votojmë kush oshtë pro që votimi të jetë i hapur. Me 16 vota për, 12 kundër dhe asnjë abstenim aprovohet propozimi për votim të hapur për çështjen e përzgjedhjes së anëtareve të komisionit komunal të ndërmarrjes Ekoregjioni. Kështu që kalojmë të emri i i të propozuarit nga Aleanca për ardhmërinë e Kosovës Hasan Përboqi dhe e qesim në votim. Më 15 vota kundër, 12 pro dhe një abstenim nuk kalon emri i propozuar nga Aleanca për anëtar të komisionit komunal të aksionareve. Vazhdojmë me propozimin e grupit nga Lëvizja Vetëvendosje Sinan Kryeziu e qesim në votim. Më 18 vota pro, asnjë kundër dhe 6 vota abstenim është emri i votuar për anëtar të komisionit komunal të aksionareve. Pastaj vazhdojmë me emrin e propozuar nga PDK-ja, e qesim në votim. Më 16 vota pro, 5 abstenime dhe 6 vota kundër, është emri i votuar për anëtar të komisionit komunal të aksionareve për ndërmarrjen publike Ekoregjioni. Gjithashtu në këtë komision do të emërohet edhe një anëtar që do të vjen prej kryetarit të komunës. Atëherë po e vendosim edhe vendimit për formimin e komisionit komunal nga komuna e Rahovecit për ndërmarrjen publike lokale Ekoregjioni në Rahovec dhe e vendosim në votim komisionin komunal aksionar nga Komuna e Rahovecit me këtë përbërje: Sinan Kryziu – VV, Sejfullah Sejfullahu – PDK dhe një anëtar që vjen nga kryetari i komunës. E qesim në votim këtë komision. Më 16 vota pro, 8 kundër dhe një abstenim miratohet vendimi për formimin e komisionit komunal të aksionareve për ndërmarrjen publike lokale KRM. Ekoregjioni në Rahovec. Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për formimin e komisionit komunal të aksionareve nga Komuna e Rahovecit për ndërmarrjen publike lokale “Stacioni i Autobuseve” në Rahovec.

Kryetari – Përshëndetje për kryesuesin e kuvendit të komunës, anëtarët e kuvendit, drejtorët e drejtorive, monitoruesit dhe gjithë të pranishmit në sallë. Normalisht që edhe në bëjmë analiza dhe në cilësinë e kryetarit bëjmë edhe vlerësime, kështu që për mos me humb kohë, po ju jap disa informacione shkurt. Tash e kemi në rend dite themelimin e komisionit për ndërmarrjen publike lokale Stacioni i Autobusëve në

Rahovec. Për here te parë stacioni i autobusëve ne mandatin tim është bërë 100% aset i komunës dhe kjo është një e arritur e madhe e komunës se Rahovecit . Pastaj për herë te parë ne komunën tonë janë zhvilluar procedura 100% me vendim te kuvendit te komunës me përkushtimin e ekzekutivit te komunës ku ka pasur edhe komision te aksionarëve pastaj ka pasur edhe bord dhe ka zhvillime shume me pozitive ne krahasim qysh ka qenë dikur si një ndërmarrje e gjithkujt dhe e askujt. Kështu ë tash për me ju lehtësua punën opozitës, e inkurajoj grupin politik te aleancës dhe meqenëse jemi krenar për punën që e kemi mbërri deri tash që si me votim te hapur apo te fshehtë dy anëtar te komisionit po besoj që grupi i aleancës nuk ka arsye me i qitë asnjë propozim për anëtar te komisionit.

Kryesuesi – Faleminderit kryetar, kërkoj aprovimin e shumicës se kuvendareve për procedurën e votimit. Me shumicë votash konfirmohet se pika e 3-të e rendit te ditës do te votohet njëjtë sikur ne pikën e dytë te rendit te ditës për formimin e komisionit te aksionareve te ndërmarrjeve publike lokale. Atëherë shkojmë me propozimet e grupit te asamblastëve pa dashur te ja cenoj te drejtën edhe te grupit te aleancës edhe pse kryetari ne emër te grupit u tërheq.

Kryetari – I kisha sugjerua grupet e partive politike si PDK-ja, LDK-ja dhe VV-ja te fusin edhe gjininë femërore për shkak te kuotës gjinore duhet me u respektua, për shkak që te mos kemi problem rreth kësaj.

Besë Bytyqi – Kryetar faleminderit për sqarimin dhe gjithashtu faleminderit që ju jep mundësin opozitës se bashkuar për me punua për komunën e Rahovecit gjegjësisht për stacionin e autobusëve pasi që ka shume punë dhe grupi i aleancës për ardhmërinë e Kosovës nuk ka ndonjë propozim për këtë por vetëm i inkurajojmë që me punua sa me shume për stacionin e autobusëve.

Leonard Morina – Grupi i Lëvizjes Vetëvendosje e propozojmë Merisa Sharku .

Edona Kryeziu – Grupi i LDK-së e propozon z. Eqrem Spahiu.

Rasim Fazliu – Grupi i PDK-së nuk ka propozim.

Kryetari – Propozoj drejtorin e Shërbimeve Publike z. Përparim Krasniqi.

Kryesuesi – Atëherë meqë i kemi vetëm dy propozime për anëtar te komisionit komunal te aksionareve për ndërmarrjen publike lokale Stacioni i Autobusëve dhe një anëtar te propozuar nga kryetari i komunës. Kështu që i qesim ne votim te tre emrat që do ta përbejnë këtë komision komunal te aksionareve për ndërmarrjen publike lokale Stacioni i Autobusëve me përbërje: Merisa Sharku – VV, Egerem Spahiu – LDK si dhe Përparim Krasniqi – ekzekutivi i komunës. E qesim ne votim. Më 27 vota pro, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, kuvendi i komunës e miraton vendimin për themelimin e komisionit komunal te aksionareve për ndërmarrjen publike lokale Stacioni i Autobusëve. Kështu që me këtë përbërje ftojë që kjo pike e rendit te ditës te votohet si tërësi si vendim i kuvendit komunal. E qesim ne votim. Konstatoj se unanimisht aprovet edhe pika e trete e rendit te ditës. Kalojmë ne pikën e katërt te rendit te ditës:

4. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për formimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorit/eshës dhe zëvendësdrejtorit/eshës së institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese para universitare (IEAAP).

Avni Morina – Përshëndetje për kryetarin e komunës, kryesuesin kuvendit, drejtoret e drejtorive komunale, asamblastët dhe gjithë te pranishmit ne sallë. Bazuar ne udhëzimin administrativ te ministrisë se arsimit nr.151/2020 për detyrat dhe përgjegjësit e drejtorit dhe zëvendësdrejtorit se institucionit publike edukativo arsimor dhe aftësues para universitar ne Republikën e Kosovës,procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, procedurat e kontratës dhe emërimit te përkohshëm, pra ky është emri i udhëzimit administrativ. Bazuar ne nenin 6 te këtij ligji përkatësisht ne paragrafin nr.3 tek komisioni përgjegjës prej institucionit arsimor ne varësi te komunës që ka këtë përbërje: dy anëtar te komunës te cilët propozohen nga DKA-ja dhe votohen nga kuvendi komunal, anëtari i parë është i punësuar nga DKA-ja dhe anëtari i dytë është i propozuar nga DKA-ja që mund te jetë ekspert i pavarur i arsimit, drejtor i institucionit te arsimit me performancë te lart, përfaqësues nga këshilli i prindërve dhe ne nivel komunal. Anëtari i komisionit i

punësuar ne DKA njehërit është edhe kryesues i komisionit. DKA ka propozuar dy emra, e ata janë Lulzim Krasniqi dhe Beatrisa Pista Demiri, kështu që ne bazë te udhëzimit adminsitrativ këtu kërkohet vetëm aprovimi.

Burim Krasniqi – Unë po konsideroj se ka nevojë vetëm me u plotësua edhe me një pikë vendimi pasi ky komision me informua kuvendin me ecurinë e përzgjedhjes se drejtoreshave. E di që pas punës se komisionit vendimin e merr kryetari por meqenëse është vendim që e nxjerr kuvendi i komunës për emërimin e komisionit atëherë me informua kuvendin për procedurat gjate përzgjedhjes me një raport informues për kuvendin.

Kryetari – Zakonisht DKA-ja jep informata te rregullta për kuvendin e komunës por edhe te gjitha raportet besoj që publikohen ne wefaqen zyrtare te komunës, kështu që edhe ashtu edhe pa e kërkuar dikush prej kuvendit e kemi për detyrë me dhanë informatë për ecurinë e punës se këtij komisioni prej dy anëtarëve nga DKA-ja përfaqësuesit apo zyrtarit te MASHT-it.

Avni Morina – Këta dy anëtar që do te provohen nga kuvendi , propozimet merren nga DKA-ja sipas udhëzimit administrativ. Nëse nuk aprovohet atëherë do te krijohet probleme që me i shtie edhe dy emra tjerë ne propozim dhe me pastaj me kërkuar prape aprovimin. Pra aprovimi kërkohet prej kuvendit mirëpo propozimet i bën DKA-ja sipas udhëzimit administrativ ndërsa komisioni që formohet prej 3 anëtarëve, dy nga DKA-ja që aprovohet edhe nga kuvendi i komunës dhe një nga MASHT-i pas përfundimit te procesit te një konkursi e ka për obligim sipas udhëzimit administrativ që këtë raport te ja dorëzoj kryetarit te komunës për raportin e vlerësimit te kandidateve që aplikojnë ne konkurset për drejtor dhe zëvendës drejtor.

Burim Krasniqi – Nuk e kontestova asnjë emër dhe nuk pata asnjë qellim sepse është përzgjedhje e juaja dhe po besoj që[duhet me qenë njerëz që i plotësojnë kriteret që mos me u kontestua emrat, por vetëm thash që ai raport që bohet për kryetarin për me marr vendim kryetari për emërim që te jetë edhe si informuese për asamblenë për punën që ka bërë ky komision, meqenëse po kërkohet votimi nga asamblistët.

Kryetari – Unë e mirëkuptoj edhe njëherë Burimin edhe mendoj se kryetari i komunës nuk parashihet me i dhanë raport kuvendit për ecurinë e konkurseve. Informata ne mënyrë te rregullt dhe periodike bën drejtorja e arsimit edhe pse mund te përfshihet edhe ecuria e rezultateve ndërsa te dhënat tjera publikohen ne webfaqen zyrtare. Me mirëkuptim po flas edhe jam shume korrekt pasi aprovimi i kuvendit është i nevojshëm për shkak se është procedurë që buron prej udhëzimit administrativ. Tash mekanizmat e kontrollit normalisht mund te zbatohen përmes informacionit që i japim kuvendit te komunës dhe ata që kanë qenë anëtar te komunës e din që jo rrall DKA e ka informua kuvendin pothuajse për te gjitha çështjet që ja ka kërkuar kuvendi edhe ashtu e ka obligim por edhe nëse e kërkon specifikisht se si kanë shkua konkurset për drejtor atëherë edhe atë ju jep.

Leonard Morina – Meqenëse ky komision prej anëtarëve dy nga DKA-ja dhe një nga MASHT-i, unë po mendoj se u deshtë me ju bashkangjitur ka një CV për shkak se drejtori e tha me herët se këta duhet me qenë ekspert te arsimit dhe me u njohua ne nga përvoja e tyre edhe ne bazë te asaj pasi nuk jam kundër këtyre dy emrave edhe pse i njoh personalisht dhe po besoj që kuvendi duhet me pas njohuri me thellësisht për përvojën e këtyre, për shkak se mos te bien edhe kuvendi ne lajthitje mëtutjeshëm.

Kryetari – Është Lulzim Krasniqi - Shefi i sektorit te arsimit I cili e ka CV-jën dhe Beatrisa Pista Demiri është disa herë drejtoreshë dhe posedon te gjitha certifikatat dhe trajnimet dhe me shume mund te konsiderohet eksperte se sa drejtoreshë e shkollës, kurse për zyrtarin e MASHT-it nuk e di sepse ata e caktojnë.

Leonard Morina – Unë kërkoja që te jetë ne mënyrë te shkruar që mos me rae ne lajthitje pasi ne e dimë që ne procese gjyqësore që gjykata ju ka kthyer prapa, kështu që do te ishte mire me pas te shkruar edhe me vazhdua tutje.

Kryesuesi – Atëherë meqë nuk kemi tjerë te lajmëruar, e qesim ne votim pikën e katërt te rendit te ditës për formimin e komisionit me përbërjen që e ka propozua DKA-ja. Me 26 pro,1 abstenim dhe asnjë kundër, aprovohet vendimi për caktimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorit/eshës dhe zëvendës drejtorit/eshes

se institucioneve edukativo arsimore dhe aftësisë para universitare. Kalojmë ne pikën e pestë te rendit te ditës:

5. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për themelimin e Këshillit për fshatin Hoçë e Madhe.

Kryetari – Fillimisht nuk jam i interesuar me qenë anëtar i këshillit te fshatit Hoçe e Madhe pasi jam kryetar i komunës dhe i dini publikisht qëndrimet e mia, mirëpo tani është koha që ne duhet me marr vendimin si kuvend i komunës për me i zhvillua procedurat e me pastaj me formua një komision per me i pranua ftesat te atyre që janë te interesuar me qenë anëtar te këshillit te fshatit Hoçë e Madhe. Siç e dimë kuvendi i komunës vendos për këtë temë, mandati është sikur i kuvendit te komunës 4 vjeçar, kështu që do te ketë te interesuar siç ka pasur ehe ne te kaluarën dhe ne duhet me marr vendimin dhe nuk besoj që duhet me pas arsye me diskutua këtë.

Burim Krasniqi – E kam lexuar ligjin për Hoçën e Madhe, kështu që përfaqësuesit e fshatit i cakton fshati direkt, përfaqësuesin e kishës ortodokse e cakton kisha dhe nuk ka nevojë me pas përfaqësues fshati ne komisionin ad hoc për zgjedhjen e anëtareve te këtij kuvendi. Unë po mendoj pika e 5-të e vendimit, ku thotë se kuvendi i komunës brenda 7 ditësh pas përfundimit afatit për aplikim, kuvendi nxjerr vendimin për formimin dhe caktimin e anëtareve te komisionit ad hoc i përberë nga 5 anëtar, 3 anëtar nga fshati dhe 2 nga kuvendi i komunës, pasi fshati i dërgon emrat e vet ne këshill e po ashtu edhe kisha emrin e vet ne këshill dhe komisioni behet prej 5 emrave ad hoc, që ska nevojë komuna me ekzekutivin me bo përzgjedhjen e anëtareve te këshillit.

Kryesuesi – Atëherë e qesim ne votim, vendimin për iniciimin e procedurave për themelimin e këshillit për fshatin Hoçë e Madhe. Me shumicë votash aprovohet vendimi për iniciimin e procedurave për themelimin e këshillit te fshatit Hoçë e Madhe. Kalojmë ne pikën e gjashtë te rendit te ditës:

6. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për formimin e komisionit për vlerësimin e performancës së kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës se paluajtshme komunale.

Kryesuesi – Ky vendim për dhënien në shfrytëzim për vlerësimin e performancës se kontratës përbehet nga 5 anëtar ku dy prej te cilëve vendosen prej kryetarit te komunës dhe tre anëtar shkojnë prej kuvendit komunal. Tani ftojë grupet e asamblistëve që te propozojnë nga një anëtar për vlerësimin e performances për formimin komisionit për dhënien ne shfrytëzim te pronës se paluajtshme.

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, nënkryetar, kolegë drejtor, asamblistë dhe gjithë te pranishmit ne sallë. Në bazë te ligjit për vetëqeverisje lokale dhe në bazë te ligjit për dhënie ne shfrytëzim dhe këmbim te pronës dhe statutit te komunës se Rahovecit, para ju keni vendimin për themelimin e komisionit për vlerësimin e performances se kontratës për dhënien ne shfrytëzim te pronës se paluajtshme komunale. Komisioni sipas pikës 1 te këtij vendimi përbehet nga 5 anëtar ku 3 anëtar propozohen nga kuvendi i komunës kurse dy anëtar tjer propozohen nga kryetari i komunës. Detyrat dhe përgjegjësit komisionit janë që te bëj perfomancen e kontratës për dhënien ne shfrytëzim te pronës se paluajtshme komunale. Ky komision pasi te formohet e ka për obligim që te përcaktoj edhe procedurat per dhënien ne shfrytëzim dhe këmbim te pronës se paluajtshme dhe gjithashtu komisioni do te filloj punën menjëherë pas miratimit dhe propozimit nga ana e kuvendit te komunës se Rahovecit . Bëhet fjalë për zonë kadastrale ne Rahovec për parcelën ku aktualisht edhe gjimnazi apo shkolla e mesme „ Xhelal Hajda-Toni,, pra behet fjalë për qendrën rinore për token dhe objektin ku është e ndërtuar qendra rinore apo SHL Kosova. Ftojë anëtarët e kuvendit që pas shqyrtimit te propozojnë dhe te aprovojnë vendimin për formimin e këtij komisioni.

Kryesuesi – Atëherë shkojmë me propozimet nga grupet e asamblistëve për vendosjen e anëtareve ne këtë komision.

Besë Bytyqi – Grupi i AAK-së e propozon z. Feriz thaqi.

Leonard Morina – Grupi i LVV-së e propozon Vlora Vuçiterna.

Burim Krasniqi – Grupi i LDK-së nuk ka propozim.

Bejtullah Deliu – Grupi PDK-së e propozon Amir Vuçitërna.

Kryesuesi – Kuvendi komunal me propozimet e grupeve te asamblistëve ka vendosur 3 anëtar ne komisionin për vlerësimin e performances se kontratës për dhënien ne shfrytëzim te pronës se paluajtshme komunale, që janë Feriz Thaqi-AAK, Vlora Vuçitërna –VV, Amir Vuçitërna- PDK, pastaj edhe dy anëtar do te emërohen nga kryetari i komunës. Keshtu që si te tillë e qesim ne votim. Me shumicë votash aprovohet vendimi i kryetarit te komunës për formimin e komisionit për vlerësimin e performances së kontratës për dhënien ne shfrytëzim te pronës se paluajtshme komunale. Kalojmë në pikën e shtatë te rendit te ditës:

7. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për shpalljen me interes te përgjithshëm publik, pjesën e parcelës P- 71510057-01472-3 ne zonën kadastrale ne Rahovec.

Afrim Oruqi – Në bazë te ligjit për vetëqeverisje lokale ligjeve ne fuqi kryetari i komunës propozon vendimin për shpalljen me interes te përgjithshëm publik pjesën e parcelës P- 71510057-01472-3 ne zonën kadastrale ne Rahovec. Propozimi i kryetarit te komunës për me shpall me interes te përgjithshëm pjesën e parcelës me numër te lartcekur pjesën e parcelës ka te bëj me sipërfaqe prej 69m2 prej sipërfaqes se përgjithshme që është 13 ari 60m2. Ne po kërkojmë nga ju që te shpallim me interes te përgjithshëm sipërfaqen me vlerë prej 69 m2 ne vendin e quajtur Padi, e evidentuar sipas certifikatës se pronës ne posedim te Mehdi Baki Shehu. Qëllimi i shpalljes se interesit te përgjithshëm publik te pjesës se parcelës te cekur ne pikën 1 te këtij vendimi do te jetë zgjerimi i rrugës pra behet fjalë për zgjerim te rrugës publike ku ne atë zonë ka rruge kadastrale me numër me emër e cila është e pamjaftueshme ne komunitet që te kalojnë për shkak te naltesisë ne atë pozicion. Pra qëllimi i këtij vendimi i shpalljes me interes te përgjithshëm vjen pas disa kërkesave te banoreve ne atë komunitet që jetojnë ne atë lagje. Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik ne rregullimin e pronës do te jetë drejtoria e gjeodezisë kadastrës dhe pronës. Ftojë anëtarët e kuvendit që pas shqyrtimit te aprovojne propozim vendimin për shpalljen me interes te përgjithshëm te kësaj parcele që pas këtij vendimi do te vijoj edhe ne procedura tjera ligjore.

Ilir Pallqa – Përshëndetje për te gjithë. Fillimisht po me vjen mirë që po interesoheni për interesin publik por unë kam disa pyetje e dilema për këtë çështje. Në radhë te parë nëse ishte kërkesë e banoreve te lagjes atëherë a mundeni me na shpërndaje dokumentin ku vërtetohet kërkesa e tyre meqenëse nuk e kemi ne material. Pastaj çka pason pas shpalljes se interesit te përgjithshëm publik ne atë pjesë, këmbimi apo shpronësimi dhe krejt ne fund a e dini se në atë parcelë sipas gjeoportalit një pjesë e objektit te ndërtuar është e ndërtuar ne pronë publike, kështu që a jeni marr vesh që te behet këmbimi ne atë pjesë dhe nëse po a e dini se po krijoni një precedent që mundet me na kushtua shume ne te ardhmen dhe a jemi te gatshëm ne si komunë me krijua këtë precedentë, që nëse ne te ardhmen dikush ka ndërtuar ne pronë publike kërkon këmbim përmes metodave te ndryshme atëherë duheni me përdor te njëjtën standard. Pra komuna është e gjithë banoreve prandaj duhet te ketë një standard për te gjithë.

Burim Krasniqi – Unë sapo mundem me pa ne propozim vendim se ka te bëj me zgjerimin e një rruge. Ne si grup i LDK-së nuk duam me krijue një paragjykim por ne parim për faktin jo vetëm ne këtë rruge por kurdo që do te ketë nevojë për me përkrah vendime te marrjes se pronës ne interes të përgjithshëm me qellim që te kthehet ne shërbime te komunitetit te qytetareve do te jem i gatshëm për me përkrah dhe si te tillë këtë vendim e përkrahim ne parim për shpalljen e pronës ne interes te përgjithshëm për zgjerimin e rrugës për banoret e asaj lagje.

Bejtullah Deliu – Lidhur me këtë pikë te rendit te ditës besoj që duhet që ti inkurajojmë qytetaret ne këtë formë që te kenë qasje ne shërbim te komunitetit dhe te shoqërisë dhe nuk mund te presim se çka ndodh ne te ardhmen, por nëse ndodh do te ballafaqohemi me pikën dhe rastin konkret edhe e shqyrtojmë Nëse mendojmë se ne te ardhmen ka pengesë për ndonjë rast nuk e votojmë dhe nuk e kalojmë por ne këtë rast

po besoj që kjo është kërkesë e duhur që kjo rrugë të zgjerohet dhe ajo lagje të lirohet dhe jemi të mendimit se është në rregull dhe duhet ta përkrahim.

Besë Bytyqi – Gjithashtu i bashkohem dy parafolësve të mi, në si AAK jemi pro këtij vendimi dhe duke falënderuar gjithmonë qytetaret për kontributin e tyre për zgjerimin e rrugëve dhe inkurajojmë të gjithë qytetaret që t'i ndihmojnë kësaj komunë dhe gjithashtu inkurajojmë edhe këshilltarët komunal mos me ardh me paragjykime apo gjëra të tjera se çka mundet me ndodhë dhe çka do të ndodhë pas dhjetë vite, kështu që si Aleancë në e përkrahim.

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues, në pyetjen e kuvendarit Ilir Pallqa, se çka pas këtij vendimi kur shpallet me interes të përgjithshëm. Kështu e ka paraparë ligji, ku fillimisht shpallet interes i përgjithshëm publik nëse kuvendi merr vendim dhe atëherë në një seancë tjetër prapë me vendimin e juaj do të keni mundësi me vendos që a dojmë me këmbye apo me shpronësua, Po ashtu sa i përket kërkesës, mund të ju them se kërkesë ka që nga viti I kaluar diku ka muaji qershor ka ardh kërkesa e pare e nënshkruar dhe e protokolluar, kështu që në seancën e radhës secilit prej juve mundet me ju sigurua fizikisht për me ju sjell në kuvend, pasi është kërkesë prej lagjes. Kurse sa i përket asaj se a ka uzurpim, atëherë drejtoria për gjeodezi kadastrë dhe pronë ka raport të detajuar për secilën parcelë që ka uzurpim në secilën zonë e sigurisht edhe për këtë parcelë nëse ka interes me ditë që ne po flasim për një pjesë të parcelës që nuk ka të ndërtuar asgjë pasi e keni skicën e terrenit secili para jush me ortofoto edhe është e drejtë e juaj e secilit me vendos dhe nëse kërkon informate atëherë në seancën e radhës ju sjelli vendimin me shkrim nëse drejtoria për gjeodezi kadastrë dhe pronë ka vendim që ka uzurpim në këtë parcelë. Pastaj a krijojmë precedent, kjo është e drejta e juaj me votën tuaj pasi nëse mendon se e ka gabim atëherë mundeni mos me votua, mos krijo precedent. Pasi ligji ka kërkuar që unë me i sjell dhe me prezantua këtë pasi ka ardh kërkesa dhe duhet me ju prezantua palëve dhe nëse ju e vlerësoni që me këshilltarët e juaj që nuk është mirë pasi unë nuk e kam sjellë këtë këtu për me krijuar precedent por kam propozua një pikë sipas kërkesës se qytetareve të asaj lagje për zgjerim. Pastaj a do të ketë shpronësim apo këmbim, unë mendoj se do të ketë këmbim pasi nuk kemi të paraparë mjete financiare për vitin 2022 për me shpronësua. Kështu që ka me pas përafërsisht në çdo seancë kërkesa të tilla dhe precedentë nuk krijojmë por punojmë sipas ligjeve dhe rregulloreve që janë në fuqi. Sipas pyetjes së kuvendarit Burim Krasniqi që ishte e përafërt me përgjigjen e fundit.

Merisa Sharku – Sa i përket kësaj çështje edhe unë jam i mendimit sikur parafolësit se materiali është i mangët se paku për sot, në mundemi me bo kërkesë që me na dhanë me pa materialin në ditët në vazhdim por mendoj se nuk na hynë në punë kur sot na kërkohet që të votojmë pro apo kundër. Kështu që unë s'mundem me votua diçka kur e kam të paqarte dhe sa i përket kësaj foto këtu që e shohim është e gjeoportalit pasi jam e fushës edhe e përdori gjeoportalin dhe është mundësia me e lartë e parcelizimit që me pa se si është ndarja e parcelave mirëpo nuk e di në këtë foto me largua vijën e kuqe.

Kryesuesi – Atëherë e qesim në votim pjesën e parcelës P- 71510057-01472-3 në zonën kadastrale në Rahovec. Me shumicë votash aprovohet pika e shtatë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P- 71510057-01997-10 dhe 71510057-01997-11 në zonën kadastrale në Rahovec.

Afrim Oruqi – Të nderuar kuvendarë, para jush keni propozim vendimin e kryetarit të komunës për shpalljen me interes të përgjithshëm publik të dy parcelave P-71510057-01997-10 dhe P-71510057-01997-11 në Rahovec. Bëhet fjalë për dy parcela që janë mbi institutin e bujqësisë në qytet afër shkollës Sadedin Hajda. Parcelat me numrat e lartcekur në zonë kadastrale me sipërfaqe ku një parcelë i ka 16 ari e 6m2 me kulturë jo pjellore në vendin e quajtur Ispo Selo e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë si prone shtetërore e Kosovës KK. Rahovec shfrytëzues NBI. Aktualisht me këtë parcelë dhe me parcelën tjetër menaxhon agjencinë kosovare të privatizimit dhe gjithashtu bëhet fjalë edhe për parcelën 01997-11 në zonë kadastrale në

Rahovec, këto dy parcela janë ne kufi njëra me tjetrën, kjo parcelë i ka 9 ari me kulture jo pjellore dhe është ne te njetin vend ne vendin e quajtur Isto Celo, e evidentuar sipas certifikatës se pronësisë ne posedim pronë shtetërore e Kosovës KK. Rahovec shfrytëzues NBI edhe kjo menaxhohet prej AKP-së. Qëllimi i shpalljes se interesit te përgjithshëm publik te parcelave te cekura ne piken 1 te këtij vendimi do te jetë ndërtimi i çerdhes për fëmijë për te gjithë banoret e komunës se Rahovecit. Autorizohet kryetari i komunës që komform ligjeve ne fuqi te ndërmerr gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi. Bartës për rregullimin e dokumentacionit do te jetë drejtoria e Gjeodezisë Kadastrës dhe Pronës ne komunën e Rahovecit. Pas miratimit nga ana e kuvendit nga komuna e Rahovecit ky vendim hyn ne fuqi 15 ditë pas dërgimit ne autoritetin mbikëqyrës ne MAPL. Edhe për këtë vendim është faza e parë sipas ligjit për këmbim dhe shfrytëzim, ku pas kësaj faze kur do te shpallet me interes te përgjithshëm atëherë do te mundohemi nëpërmjet bordit te AKP-së dhe qeverisë se Kosovës që te na kthejnë ne pronësi e këtyre dy parcelave dhe te shfrytëzoj për nevoja te komunës për zhvillim ekonomik. Ftojë anëtarët e kuvendit që te votojnë për propozim vendimin për shpalljen me interes te përgjithshëm te këtyre dy parcelave.

Rumir Zhuniqi – Në emër te grupit te AAK-së e dimë rëndësinë e kësaj prone pasi është pronë e AKP-së apo menaxhohet nga ata mirëpo interesi jonë është që kjo pronë te kalojnë ne pronë te komunës se Rahovecit dhe te shfrytëzohet për interesin e komunës. Andaj sipas planifikimit te buxhetit te qeverisë se Kosovës ne Ministrin e Arsimit është planifikuar ndërtimi i një çerdhe ne komunën e Rahovecit, pasi siç e dimë ne Rahovec konkretisht ka pak prona publike që mund te shfrytëzohen për infrastrukturë te përgjithshme, kështu që ne këtë rast e kemi mundësin që ne këtë hapësirë dhe si lagje e madhe që është ne këtë zonë te ndërtohet çerdhja ashtu siç është e planifikuar nga Ministria e Arsimit. Kështu që ne si grup i aleancës e përkrahim propozim vendimin për shpalljen me interes te përgjithshëm publik te dy parcelave.

Merisa Sharku – Për këtë çështje kam vetëm një pyetje, sa i përket kësaj pajtohem me parafolësit pasi edhe ne jemi pro asaj që bëhet për te mirën e komunës dhe qytetareve te komunës tonë. Deri ku kanë mbërri procedurat pasi që e dimë që qeveria e Kosovës ne amendamentin e kërkuar nga deputeti i komunës tonë është miratuar për me ndërtua një çerdhe ne komunën e Rahovecit dhe gjithashtu me ndërtua një shkollë ne fshatin Pastasel, kështu që desha me pyet drejtorin se deri ku kanë mbërri procedurat dhe me pas një çasje adekuate që mos me ngec si procedurë.

Kryetari – Siç e dini që ne kod e kemi për ndërtimin e një çerdhe ne qytet dhe një shkolle fillore ne Pastasel, pra ne kodin e Ministrisë se Arsimit dhe për këtë besoj që jeni ne dijeni. Ne e kemi përcaktuar vendin për çerdhe pasi kemi te drejtë ne pronë komunale me përcaktua vendin për çerdhe. Mirëpo këtu ne vendim përmendet me shume se një çerdhe, kështu që ideja jonë dhe synimi i jonë besoj i përbashkët ,që pse mos ta marrim pronën që e kemi te shkollla e mesme Sadedin Hajda dhe me bo pronë komunale nga AKP-ja, pra kjo është qëllimi dhe që mund te na shërbej nëse jo për çerdhe atëherë për diçka tjetër. Pra qëllimi i këtij vendimi pasi nëse neve na pranojnë qeveria edhe AKP-ja atëherë do te ishte më mirë dhe vendi me i përshtatshëm te shkollla Sadedin Hajda se sa ne vendin ku ne e kemi përcaktua siç patën kërkuar që te përcaktohem për lokacionin për me pas mundësi me fitua çerdhen. Tash e kemi një pronë ku jemi përcaktua si komunë por ta kemi edhe një pronë tjetër që menaxhohet nga AKP-ja dhe ta bëjmë pronë tonën, që ndoshta edhe mundet mos me na nevojit për çerdhe nëse nuk ka nevojë por që mundet me nevojite për diçka tjetër, kështu që mundet me u korrigjua vendimi por vendimi për me shpall atë parcelë zonë te interesit te përgjithshëm publik po besoj që nuk do te duhet me pas as pozite e as opozite por te gjithë duhet me qenë bashke sepse është ne vend jashtëzakonisht te përshtatshëm. Pra ne vendin e kemi për çerdhe por me shpejtua kjo që te kemi mundësi me marr nga AKP-ja atëherë sigurisht se ky vend është me i mirë. Por tani për mos me vonua kërkesën e ministrisë që na kanë thanë qe me u përcaktua atëherë ne e kemi dërgua dokumentin për shkak se ka afate. Kështu që nëse e marrim sa me shpejt këtë atëherë ne mund te ja dërgojmë ministrisë se arsimit edhe me i than se kemi edhe një vend tjetër që kemi marr nga AKP-ja por nëse vonohet si procedurë atëherë kurdo që vjen pozitivisht atëherë neve na duhet ajo pronë që ta kemi si pronë nen administrimin dhe menaxhimin e komunës se Rahovecit.

Kryesuesi – Sa për sqarim kryetar kisha kërkuar nga ju që të mos jemi në lajthitje, rreth procedurës për çerdhen në fjalë siç e bëri edhe pyetjen Merisa Sharku janë në përfundim e sipër por është një parcelë tjetër që kërkohej të votohej. Pra parcela në fjalë që ka me u votuar është arsyetimi për çështjen që me pas mundësi me marr nga AKP-ja pronën dhe me bo pronë me interes të përgjithshëm publik por në një të ardhme të afërt që kryetari mund të na shpjegojë me mirë.

Kryetari – Pra duhet që ta qartësojmë, neve nuk na pengon që me marr këtë edhe le të shkruan çerdhe që me pas mundësi që nëse na duhet edhe një çerdhe edhe mund ta bëjmë por nëse nuk na duhet atëherë mund ta bëjmë diçka tjetër. Sa i përket procedurave presim informacione nga bordi i AKP-së dhe në momentin kur marr vendim kuvendi me shpall zonë të interesit publik atëherë në presim vendim nga qeveria kur arsyetohet mirë apo prej bordit të AKP-së. Dhe nëse vjen ajo atëherë në mund të ripërcaktohem për vendin e çerdes atëherë mund të ju themi ministrit se kemi marr një pronë nga AKP-ja dhe është vend me i përshtatshëm për çerdhe.

Eqerem Spahiu – Faleminderit kryesues, nuk e kemi të qartë se për cilën parcelë po bëhet fjalë, nuk kemi asgjë kundër për këtë mirëpo duhet që ta kemi të qartë se për cilat parcela behet fjalë dhe ku është vendi.

Afrim Oruçi – Behet fjalë për dy parcela që janë të ngjitura njëra me tjetrën në hyrje të Rahovecit në rrugën Xhelal Hajda Toni në anën e majtë ku është e ndërtuar një shtëpi e shëndeti, pastaj është instituti bujqësor dhe mbështetja institutit bujqësor ku me herët kanë Trupat e Mbrojtjes së Kosovës janë këto dy parcela, ku njëra parcelë ka 16 ari dhe tjetra i ka 9 ari. Këto dy parcela janë prona shtetërore të Kosovës por menaxhohen nga AKP-ja. Në pyetjen se deri ku kemi mbet me procedura, në kemi pasur afat ligjor deri me 22 shkurt që me i dorëzua të gjitha dokumentet në ministrinë e arsimit, kështu që në bashkë me drejtorin komunal të arsimit i kemi prezantua të gjitha dokumentacionet për të gjitha ato që i kanë kërkuar ata dhe limit apo fati kësaj ka qenë 22 shkurti. Dhe për këtë arsye për shkak se kjo procedurë na merr me shumë se një muaj, në jemi përcaktuar për një pronë që është komunale e Rahovecit. Përndryshe këta nuk pranojnë dokumentacion që menaxhojnë agjencioni kosovar i privatizimit. Kështu që nëse kjo aprovohet dhe kalon në bord të AKP-së dhe në qeverinë e Kosovës atëherë kryetari i komunës ku ta shoh me të arsyeshme dhe ku është me në interes të qytetarëve, përndryshe siç e tha kryesuesi që nuk kemi qejf me rae në lajthitje. Kështu që unë i them se kam nis me u ndie keq pasi nuk jam këtu për me lajthit askënd pasi edhe unë jam qytetar i këtij vendi dhe qëllimi i jonë është sikur i juaji pra qëllimi i përbashkët për interesin e përgjithshëm. Kështu që kurdo që këtë pronë e kthejmë dhe e bëjmë pronë komunale atëherë bashkë me juve dhe kryetari i komunës vendos se ku është me mirë, kështu që në për me mirë po mendojmë se është atje por për momentin pasi që është e AKP-së nuk kemi të drejtë me aplikue pasi na refuzojnë, mirëpo në po tentojmë që me marr edhe me bo pronë të komunës të Rahovecit dhe kjo është qëllimi i kësaj dhe gjithashtu nuk është mirë me heqë qëllimin të pika pasi këto dokumente të juaja do të shkojnë të AKP-ja dhe është shumë mirë me lanë që qëllimi është për me ndërtua çerdhe jo vetëm një por me shumë çerdhe, pra qëllimi është mirë me lanë sepse bordi e shoh të arsyeshme edhe kur e dërgon në qeverinë atëherë edhe ajo e shoh të arsyeshme atëherë na kthen pronat dhe me pastaj në rivendosim.

Shqipe Kryeziu – Është viti i peste që jam këtu dhe nuk pata asnjë qëllim me u ndërlidh të ajo që me përqesh dikënd pasi kam njëfarë edukate por vetëm deshta me komplementue drejtorin kryetar dhe gjithë kabinetin dhe gjithashtu meritë e jona është pasi edhe në jemi kuvendare dhe po kontribuojmë për këtë dhe nuk e pata me fye askënd apo me repliku me dikë.

Kryesuesi – Faleminderit të gjithëve, atëherë e qesim në votim pikën e tetë të rendit të ditës. Më shumicë të votave aprovohet vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm të parcelave P-71510057-01997-10 dhe P-71510057-01997-11 në zonën kadastrale në Rahovec. Kalojmë në pikën e nëntë të rendit të ditës:

9.Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2021 në vitin 2022.

Afrim Limani – I nderuar kryesues, kryetar, nënkryetar, kuvendarë dhe gjithë ju të pranishëm. Bartja e mjeteve nga viti 2021 në vitin 2022 është përcaktuar me ligjin e financave publike dhe përgjegjësi përkatësisht nëni 9,pika 2.1. Shuma e bartur e mjeteve për komunën tonë nga viti 2021 në vitin 2022 në total

është prej 592,276 euro. Tepricë te mjeteve apo tejkalim te te hyrave vetanake kemi ne shumen 436,779 euro ndërsa pjesa prej 154,584 euro është pjesë e mbetur nga te hyrat vetanake ne kuadër te projekteve që kanë qenë te planifikuara gjate vitit 2021. Pas një analize te mire nga drejtoria e financave dhe buxhet duke bërë një analize te mire te projekteve ne raport me obligimet dhe borgjet te cilat i kemi, gjithmonë duke ditur edhe rezervat që kanë filluar nga viti 2019 një udhëzim administrativ 06/2019 se kushtimisht një numër i madhe i projekteve kapitale për vitin 2022 i kemi ne rezerva dhe atëherë ju kemi dhënë prioritet edhe disa projekteve kapitale te cilat janë ne kuadër te rezervave. Gjithashtu prioritet tjetër ju kemi dhanë edhe disa projekteve te vjetra që kemi pas borgje dhe nje pjese te projekteve që kanë qenë te planifikuara ne kuadër te investimeve kapitale për vitin 2022 mirëpo kanë qenë te pa buxhetuara. Tash psh ndërtimi i shkollës filloore te mesme ulet Bekim Sykla ne Rahovec pastaj ndërtimi i shkollës fillore te ulet Hamëz Thaqi ne Xerxe, ndërtimi i aneksit për shkollën fillore 4 Dëshmoret ne Ratkoc, pastaj ndërtimi i muzeut për shkrimtarin dhe atdhetarin Sylejman Krasniqi. Pra këto projekte kanë qene te planifikuara mirë mirëpo ju te buxhetuara, pra me këtë bartje konsiderojmë që është mirë te ndahen një sasi te vogël te mjeteve që me iniciua procedurën për fillimin e punëve. Gjithashtu janë edhe disa projekte që për një arsye apo tjetër kanë ngelur si borgje apo obligime, që e kemi projektin ndërtimi i rrugëve ne Drenoc, Çifllak, Dejn, Malësi e Vogel, Optrush ne vlerë prej 3,000 euro pastaj kemi edhe ndërtimi i rrugëve ne Hoçe te Vogel Brestoc Krushe e Madhe dhe Fortesë që gjithashtu edhe ky projekt i vitit 2016 që la ngelur pa krye obligimet financiare për arsye te ndryshme sepse mundemi me than se operatori nuk i ka krye punët deri ne atë fazë edhe ne nuk kemi pasur faturë. Faturën e ka dorëzuar gjate vitit 2021 dhe ne mendojmë që këto borgje me i shlye me këtë vendim te bartjes se mjeteve. Siç thash edhe ne fillim i kemi edhe disa projekte që kanë kaluar ne rezervë dhe për shkak se e kemi obligime kontraktuale edhe kemi lidhur kontrata me ato projekte, ne pamundësi me i pagua ato derisa janë ne rezerva dhe mundësia e rrezikut është që prap mos te kalojnë ato projekte atëherë ne i kemi menduar që te ndajmë edhe një sasi te mjeteve për mbulimin e këtyre projekteve siç janë intervenime emergjente ne infrastrukture, furnizim me gypa PVC edhe hartimi i projekteve te ndryshme. Pra shuma e përgjithshme për bartje te mjeteve është 592,276 euro. Të nderuar asamblistë, kërkoj nga ju ë ta votoni këtë pikë te rendit te ditës sepse nëse nuk votohet atëherë këto mjete mbeten te bllokuara deri ne vitin e ardhshëm.

Bejtullah Deliu – Përsëritet për te gjithë. Prezantimi i drejtorit për bartje te mjeteve nga viti 2021 ne vitin 2022 nga te hyrat vetanake siç shihet, po mendoj se duhet te jemi me specifik dhe te sakte rreth mjeteve si p.sh. te pika 2.4 që është me kodë te ri buxhetor që është vendosur tani ndërtimi i qendrës për magazinimin te prodhimeve bujqësore, faktikisht nëse janë mjetet e vitit te kaluar kanë teprua nga viti i kaluar por pse te bëhen këto mjete për një projekt te ri dhe ky projekt edhe nëse tash i specifikun edhe është vendos për me u punua, do te ishte mirë te prezantohet se sa është totali i projektit, për sa kohe kryhet ky projekt, cili është interes i përgjithshëm ne rajone, a ka edhe ndonjë projekt tjetër i ngjashëm që te përfshihet komuna ne tërësi, kështu që me thjesht është ne interesin e bujqve dhe ne interesin e qytetareve por te ky kod buxhetor te kjo pika b 2.4 duhet te furnizohemi edhe me shume me materiale shitesë. Po ashtu e pash te shpenzimet pika 2.1 ndërtimi i rrugëve Çifllak Dejn Malesi e Vogel Optrush te cilat nuk specifikohen se cilat janë që ne KPF duhet te tregohen se cilat janë ato rruge me emër me emër te rrugës përveç fshatit ku oshtë ajo rruge sa metra është ajo rruge sa zgjat qfar ndërtime janë dhe nëse këto mjete i mbulojnë, paramendoni te gjitha këto fshatra dhe te mbulohen me 3,000 euro nuk e di se çka do te ndërtohet apo si është ndërtuar këto rruge. Kështu që kisha kërkuar sqarim nga drejtori e sidomos te kodi i ri dhe gjithashtu mendoj se duhet material shitesë që ta kemi me te qartë se për çfar behet fjalë dhe te shohim si projekt ne tërësi rreth fillimit dhe mbarimit rreth kësaj.

Sinan Kryeziu – Unë veç deshta me bo si pyetje edhe me komentua rreth saja që është parapare për shumen 16,000 ndërtimi i çerdhes ne Xerxe pasi edhe vij nga aty, po ashtu rreth 60,000 janë planifikuar pe ndërtimin e shkollës fillore Hamëz Thaqi ne Xerxe. Kështu qe tash e kam shume te paqarte pasi me këtë shume 60,000 është e palogjikshme te behet ky ndërtim pasi me këtë shume nuk ndërtohet qoftë edhe një shtëpi, ndoshta kanë mendua me rinovua shkollën e jo me ndërtua një shkollë me mbi 500 nxënës sa është shkolla fillore Hamëz Thaqi ne Xerxe. Po po ashtu edhe tek çerdhja e Xerxes, me shumen prej 16,000 kom parasysht se kanë

stagnua punimet aty dhe kisha deshtë me na informua se kur planifikon me lëshua ne funksion çerdhen e fëmijëve ne Xerxe.

Burim Krasniqi – Faktikisht bartjen e mjeteve po e kuptoj se janë te hyrat që kanë ndodhë prej periudhës se mbylljes se vitit buxhetor e që janë te nevojshme për me u bart, por i drejtohem drejtorit këto mjete siç e ceku edhe Bejta se janë shume te vogla ne disa vende, a do te kryhet obligimi krejt apo vetëm po tentohet veç me i mbulua një pjesë dhe me mbet përsëri pa mbyll obligimet. Kështu që nëse mbyllet krejt obligimet atëherë po pajtohem ne parim por nëse nuk mbyllet komplet atëherë le te ndalet te një projekt që te finalizohet komplet financiarisht dhe atëherë le te mendohet për projektin tjetër. Pasta tek furnizimi me gypa PVC, aty ku ka nevojë për kanalizime a ekziston mundësia me u parapa nga komuna edhe me gypa që mos me krijua obligime nën kontraktuale .Te shkolla ne Xerxe sa e kam pae unë, është shtie si kod i ri buxhetor që për vitin 2022 nuk ka pasur mjete hiq dhe me këtë po tentohet që me pas mundësi me shpall tenderin për fillimin e ndërtimit projekt katër vjeçar , te shume totale 240,000 që nuk e di se a mbulohet me këtë shume një shkolle fillore nëse tentohet me ndërtua prej fillimit, pasi për 3 vite shume totale e projekcionit ne buxhet është 240,000 euro.

Afrim Limani – Faleminderit për pyetjet, do te përgjigjem me radhe ashtu siç i keni parashtrua pyetjet juaja. Ne pyetjen e parashtruar nga Bejtullah Deliu sa i përket çështjes se magazinimit te produkteve bujqësore që te njëjtën pyetje e keni parashtruar edhe ne KPF, që te them te drejtën nuk kam pasur edhe informata te mjaftueshme por afërsisht ne vija te trasha ju kam shpjeguar. Ne fakt ne do te hapim një projekt te ri për qendrën e për grumbullimin e produkteve bujqësore dhe kjo është edhe një premtim i kryetarit te komunës gjate fushatës dhe që ka dal si rezultat i kërkesave te shumta te qytetareve. Në mbledhjen e KPF-së thatë kjo është ide e jem ja por unë ju them që kjo është një ide e kahershme e kryetarit për ta ndërtuar një qendër për grumbullimin e produkteve bujqësore dhe kjo do te ndërtohet te shtëpia e verës apo tregu i rrushit ne periferi te qytetit te Rahovecit dhe për me tepër sigurisht se do të flas kryetari për këtë projekt. Pastaj pyetja tjetër ishte se a kemi te drejtë me hap projekte te reja , me plot përgjegjësi ju them se bartje te mjeteve atëherë kemi drejt edhe me hap projekte te reja e po ashtu kemi te drejtë edhe me rishikim te buxhetit por me ridestininim nuk kemi te drejtë. Pra janë 3 procese gjate vitit fiskal që munden me u bo bartja e mjeteve. Pastaj te ndërtimi i rrugëve me vlerë kaq te vogël, unë mund te ju them se kur e kemi marr pushtetin ne vitin 2018 vijojnë kontrata e vitit 2016 operatori ka pasur ndoshta edhe 50% te mbylljes se kontratës, kështu që gjate këtij mandati i ka krye punët dhe e ka zbatua kontratën mirëpo ka ngelur edh 3000 euro pa paguar mirëpo ne nuk e kemi ditur dhe tek vitin e kaluar e ka dorëzuar faturën prej 3000 euro dhe ne kemi qit si obligim edhe pasi është si borgj i vjetër atëherë ne dëshirojmë me shlye këtë si borxh, po ashtu njëjte janë edhe projekte te tjera. Pastaj ne pyetjen e parashtruar nga Sinan Kryeziu rreth ndërtimit te çerdhes ne Xerxe , lirisht mund te them se me ato mjete e përmbysim kontratën edhe nuk kemi obligime ndaj operatorit edhe po shpresoj që operatoret tash ne pranverë do te i kryejnë te gjitha punët dhe do te hapet çerdhja. Pastaj te pyetja e drejtuar nga Burim Krasniqi që e thash edhe me herët se kemi nda enje sasi te mjeteve për shlyerjen e borgjeve dhe ne momentin kur shlyhen këto borgje edhe mbyllen kontratat dhe atëherë mund te them me përgjegjësi te plot se borgje nuk kemi deri ne vitin 2018 që është një shume simbolike që edhe me këto bartje sigurisht se do te zvogëlohet dhe nuk e besoj që do te mbetet borgj ne vitin 2018 sikur që i kemi pasur këto dy projekte, te vitit 2016 që është 33,000 ndërtimi i rrugës Hoçë e Vogel-Brestoc pastaj ne vitin 2017 rreth 3,003 euro ndërtimi i rrugës Çifllak Dejn Malësi e Vogel dhe ndërtimi i kompleksit përkujtimor 3499 euro që është borgj i vitit 2018. Kështu që realisht me këtë vendim te bartjes se mjeteve borgje nuk kemi nga viti 2017 e me poshtë. Pastaj rreth furnizimit me gypa PVC se pse nuk futen ne kuadër te projekteve, mund te ju them ky projekt na ka ndihmuar sepse ne këtu kemi kursye shume buxhet. Jemi dëshmitar se çdo dit po rriten lagjet por edhe ne fshatra te tjera, kështu që qytetaret kanë interesim me u furnizua me gypa dhe punët tjera i kryejnë vet qytetaret me kontributin e tyre mirëpo ne vetëm e bëjmë furnizimin me gypa PVC dhe kjo është arsyeja e kemi lanë si kodë edhe duhet me qenë si kodë. Gjithashtu edhe për shkollën ne Xerxe ne kemi planifikuar si projekt mirëpo ka qenë i pa buxhetuar edhe me këtë vendim po e bartim një shume simbolike te mjeteve sa me inicia

procedurat për me hapë tenderin apo me fillua punimet, pasi një projekt me detal ende nuk e kemi dhe po besoj që shume shpejt do ta bëjmë por nuk besoj që do te jetë me një kosto me te madhe.

Kryetari – Me rëndësi që qendra për magazinimin apo ruajtjen e prodhimeve bujqësore është mirë me u bo dhe unë kam pasur një takim se shpejti me ministrin e zhvillimit rajonal dhe ne prandaj e kemi hapur si kodë te ri dhe ne po besojmë që në një projekt dy vjeçar ka me marr pjesë ministria e zhvillimit rajonal me na ndihmua neve si komunë që me ndërtua qendrën për magazinim apo për ruajtjen e prodhimeve bujqësore. Kështu që shpresojmë që në një periudhë afatmesme tash krejt kjo varet se sa na ndajnë për këtë por që po besojmë brenda dy vite mund ta kemi një qendër te madhe te magazinimit te prodhimeve tona bujqësore afër tregut te rrushit pasi projektin dhe lokacionin i kemi. Afati për aplikim ne MZHR është deri ne 11 Mars dhe jemi marr vesh me ministrin se për cilat projekte dojmë me aplikua dhe kemi shpresë se do te marrim një buxhet te mirë nga Ministria e Zhvillimit rajonal. Prandaj jemi detyruar me hap si kod te ri sepse duhet edhe participimi I komunës. Pastaj për shkollën filllore Hamëz Thaqi pajtohem me Burimin dhe cilindo që e shprehu, pastaj per shkollën Bekim Sylka pastaj aneksi i shkollës fillorë 4 Dëshmoret ne Ratkoc me 240,000 euro nuk kryhen, e po ashtu është e vërtetë që ne projeksione buxhetore del ajo shifër por ne prape si kuvend i komunës ne shtator te këtij viti dojmë me i ndërrua projeksionet buxhetore. Atëherë pse ne kemi insistuar që me qit pare ne këto kodet e reja, për shkak se ne i kemi hapur kodet ne përbërjen e kaluar te kuvendit dhe kemi vendos me i buxhetue ne këtë vit për shkak se kemi shpresua që ministria e arsimit ndoshta edhe me rishikim te buxhetit me përkrah njëren prej këtyre tri shkollave ashtu siç e kanë përkrah shkollën ne Pastasel por edhe ne kemi bërë kërkesë për katër shkolla duke përfshirë shkollën ne Pastasel edhe një çerdhe ne qytet e kanë përkrah ministria ee arsimit. Kështu që tash është e vërtet se me 240,000 se nuk mund te behet një shkolle por tash ne i kemi buxhetue këto kode aq sa kemi pasur mundësi buxhetore edhe po besoj që me një afat optimal dhe po ashtu me qellua operatori i fort si Euroing apo Mendi-P atëherë ata kanë mundësi me i krye edhe para se me skaduar kontrata por me qellua ndonjë operator i dobët siç e kemi pasur rastin ne shkollën Sadedin Hajda prej kohës se z. Vehapi kur ka qenë kryetar e ka buxhetu dhe e ka lidh kontratën ministria e administratës publike ka qenë atëherë dhe ende nuk e kemi lëshuar ne funksion për shkak se operatori ka qellua i dobët dhe i kadalshëm. Unë po besoj që këto 4 kode te reja për 3 shkollat dhe 1 për qendrën për magazinimin e produkteve bujqësore janë shume te rëndësishme me u përkrah edhe për faktin që ne dëshirojmë me bo diçka edhe përkundër faktit që kemi obligime dhe marrëdhënie kontraktuale por gjithashtu po besojmë qe edhe qeveria ka me sjellë fonde dhe po ashtu donatoret do te na ndihmojnë me ndonjë fonde neve si komunë. Furnizimi me gypa PVC unë e kam hequr nga kodi por nuk duhet me harrua se edhe ai është borxh, kështu që edhe unë jam dakord me burimin për shkak se edhe pse i ka ndihmuar buxhetit te komunës ashtu siç e tha drejtori Afrim Limani mirëpo me mirë do te ishte me bo ndonjë kanalizim te ri se sa me ja lanë komunitetit prandaj edhe e kemi larguar kodin për furnizim mirëpo edhe ministria e ka lanë ne rezervë. Unë mendoj që drejtori i Financave Afrim Limani se bashku me ekzekutivin është kujdesur që ti shikojnë prioritetet ti eliminojnë borxhet që janë me te hershme sepse ne këtë kuvend edhe vet Burimi e ndoshta edhe dikush tjetër e ka përmend ne seancën e parë kanë thënë që borxhet që figurojnë me herët duhet me u përmbyll dhe kjo është mirë edhe për shkak te ligjit por edhe auditori nëse i konstaton atëherë mundet me te jap vërejtje e rekomandime. Një pjesë e borxheve që kanë qenë ne periudhën e mëhershme do te kryhen me kete bartje dhe që shpresojmë edhe me fondin rezervë pasi askush nga ju nuk foli për çështjen e kontratës kolektive dhe nëse ju kujtohet ne debate publike ju kam thënë që ne me bartje te mjeteve duhet me pa ne kontratë dhe tash qeveria me ligjin për ndarje buxhetore ka vendos nenin 12 e ka krijuar këtë fondin rezervë pothuajse për te gjitha komunat i cili parashihet me u shpenzua përmes nëse kemi vendime gjyqësore apo situata tjera sikur qe e kemi me kontratën kolektive, kështu që ne fondin rezervë ne i kemi 690,000 euro kështu që ja 390,000 do ti kemi vetëm për kontratën kolektive dhe me i prit vendimet që na vinë dhe me i zbatu. Pra e ka gjet çelësin qeveria meqenëse nuk po i paguan vet e që u deshtë me i pagu vet atëherë komunave ju ka krijuar këtë fondin rezervë e veçanërisht krijimi i kodeve rreth hartimit te projekteve, pasi i ka blloku disa projekte për me kriju fondin rezervë ne funksion te zbatimit te kontratës kolektive. Pra besoj që këtë informatë ndoshta nuk e keni pasur, kështu që ju ftojë me votu sepse tek e fundit do te ishte mirë me i pagua këto borxhe

sa kemi mundësi se sa me krijua precedencë dhe me i marr me procedura përmbartimore apo nga thesari. Kështu që kërkoj nga anëtarët e kuvendit me pas mirëkuptim edhe me votu pasi që na kanë teprua mjete sepse kemi tejkalua planin e të hyrave edhe këto mjete përveç një shume të caktuar që nuk ke mundësi me i shpenzua gjatë kohës tetor dhe nëntor por të gjitha mjetet tjera por edhe nga të hyrat vetanake i kemi shpenzua, por kemi tejkalim të planit të të hyrave dhe kjo na ka mundësua neve që tash me mbulua edhe ndonjë obligim apo borxh që mund ta kemi.

Bejtullah Deliu – Deshta cekë se kur është në interesin e qytetarëve të bëhet një punë atëherë nuk ka rëndësi se ide e kujt ka qenë, jemi të gjithë të mendimit se duhet të bëhet dhe duhet të votohet. Mirëpo kërkesa jone në vazhdimësi dhe kjo është vërejtje prej fillimit të seancës se kemi mungesë të informatave në pikat që i prezantoni pasi secila drejtori duhet të jetë pak me e kompletuar sa i përket materialit dhe nuk e kontestojmë dhe nuk jemi kundër operatorëve sepse ata kanë punua edhe duhet të kryhet pagesa ndaj tyre e gjithashtu edhe borxhet duhet të shlyhen dhe kjo është kërkesë shume me vend që duhet të mbyllet borxhet e vjetra dhe të fillohet me procedura ose me punë të mirëfillta ti dihet fillimi dhe mbarimi ku merren mjete dhe si merren, Pra qëllimi që mora edhe fjalën është që nuk besoj që ka ndonjë kuvendarë që është kundër punës mirë ideve të mira kundër pagesave të punëve që bëhen mirëpo vetëm është vërejtja në vazhdimësi që duhet të jemi pak me preciz dhe me të kompletuar që secili drejtor që ne të ardhmen shpresojmë që të kemi pika që ti lexojmë se paku e paraprakisht të mos ndalemi neper nënpika, pasi e parashtrova si kod të ri që e pash aty, kështu që mendoj se do ushte me në rregull sikur që e ceku kryetari që brenda dy vite të kryhet kjo procedurë, pra është e udhës që të kemi informata paraprakisht, mendoj që do të pajtoheni edhe ju kryetar por edhe ekzekutivi në tërësi.

Kryetari - Projektin ideor për qendrën për magazinim të produkteve e kemi por projektin për 3 shkolla nuk e kemi për shkak se në vërtetë i kemi hap si kod por kemi shpresua që zakonisht kur i merr ministria atëherë ajo i bën projektet vet, pra nuk jemi të përgatitur kur bahen projektet shpejt dhe tash në i kemi buxhetu kështu që shume shpejt do të bëhen projektet për 3 shkollat dhe gjithashtu projekti kryesor për qendrën për grumbullimin e produkteve bujqësor. Pra këto detaje si skicat vendin matjet por projektin kryesor për qendrën për magazinimin e produkteve bujqësore nuk kemi siç nuk e kemi as për shkollën në Xërxe, as për shkollën Bekim Sylka në Rahovec dhe as për aneksin e shkollës 4 Dëshmoret në Ratkoc. Kështu që nëse i merr tash ministria në nuk e kemi ditë ende nuk e kemi krejt buxhetin pra ligji për buxhet ende nuk e ka publikue dhe nuk e di pse edhe pse ka marr votën e parlamentit, kështu që po ti kish financua ajo atëherë ata vet i bëjnë projektet vet por në këtë rast hapim kod në edhe në duhet të bëjmë projektin. Tash në kemi përvojën e duhur se sa kushton një shkollë apo një çerdhe kështu që kemi disa përvoja që neve na thonë që projekSIONET buxhetore për vitet në vazhdim duhet me i ndërrua nëse financohet nga komuna por unë uroj që të kemi bashkëfinancim se paku bashkëfinancim me qeverinë e Kosovës.

Brim Krasniqi – Nuk po e kontestoj çështjen e votimit të bartjes së mjeteve pasi realisht po pajtohem. Sa i përket qendrës grumbulluese a do të bëhet në partneritet publiko privat, a do të jetë projekt i komunës që nuk ka mundur me pas në shfrytëzim apo formën se si ka me funksionu ajo pasi në kemi një model të partneritetit të rasti Agrocelina, pasi unë jam shume i interesuar me funksionu diçka e tillë pasi i shërben bujqve në mbrojtjen e produkteve pastaj nuk ka nevojë me dal në treg qoftë e rrushit apo specit por vetëm me intereson forma pasi po votojmë diçka që ka me ndodhë nesër a ka me shkua në partneritet publik e privat apo ka me qenë projekt i komunës që ka me dhanë në shfrytëzim prej operatorëve apo bujqëve apo bizneseve të ndryshme.

Kryetari – Me thanë të drejtën e keni shtrua një[çështje që është shume nevojshme dhe me vend, tani nuk mund të flasim me saktësi në këto momente por dëshira jonë është me ndërtua këtë objekt nga donatorët e jashtëm apo në bashkëpunim me qeverinë. Pra tash sfida e madhe do të jetë edhe menaxhimi dhe administrimi dhe mënyra se si do të funksionalizohet. Kështu që me sigurinë me të madhe ky kuvend i komunës do të mbledhet një ditë edhe ka me thanë se kujt do ti jepet në shfrytëzim pasi ka kërkesa për me dhanë në shfrytëzim dhe jam i bindur se kapacitetet profesionale dhe institucionale nuk ka me mbajt vet dhe asnjë komunë e Kosovës, kështu që me siguri duhet me dhanë në menaxhim apo në shfrytëzim të grupe fermerëve apo si

kooperativë por që duhet me shpreh interesin për ankand publik dhe nëse shprehin interesim ata operator te caktuar me u kyq atëherë ne i qesim kriteret si kuvend. Mirëpo se a mund te behet ndërtimi me partneritet publiko privat, unë mendoj se është mjaft e vështir për shkak se ende nuk kemi një momentum pozitiv cilido nga ne mund te mendoj diçka, që ne te ndërtojmë një qendër që ka një shume te madhe mirëpo nuk mund ta dimë se çfarë mund te behet me atë qendër . Prandaj ne si sektor publik dhe ne këtë rast si komunë ne e ofrojmë objektin pra hapësirën e bëjmë te gatshme dhe besoj q[çështja e menaxhimit ka me qenë menjëherë hap i radhës si sfidë dhe qellim i madhe i te gjithëve dhe po besoj që kuvendit do ti mbetet përgjegjësi se si do te menaxhohet. Kurse ndërtimi do te ndodh për shkak se ndoshta ndërtimi i kësaj qendre ka me ndihmua ministrin e bujqësisë edhe qeverinë pavarësisht se kushdo që është ne qeveri që me marr shembull një qendër te madhe si kjo dhe ndoshta edhe me buxhetue ata vet pastaj që ne te ardhmen me bo edhe ndonjë qendër tjetër vet sepse nuk do te jetë e mjaftueshme vetëm kjo, pasi që meqenëse jemi komunë me treve tipike bujqësore atëherë sigurisht se ka me pas nevojë edhe për 3-4 qendra tjera ne rajone te caktuara te komunës se Rahovecit. Kështu që kësaj radhe duhet me ndërtua vet na si komunë apo ne bashkëpunim me qeverinë kemi një ofertë me Ministrin e Zhvillimit Rajonal na kanë mbështetur për këtë dhe mbesim me shpresë se ndihma e tyre do te konkretizohet edhe financiarisht.

Kryesuesi – Faleminderit kryetar, atëherë e qesim ne votim pikën e nënte te rendit te ditës. Më shumicë votash, kuvendi komunal e miraton vendimin për bartjen e mjeteve vetanake te pashpenzuara nga viti 2021 ne vitin 2022. Kalojmë ne pikën e dhjetë te rendit te ditës:

10.Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për mbulimin e shpenzimeve te varrimit pë vitin 2022.

Kryetari – Ne kemi një dakordim me këshillin e bashkësisë islame dhe nuk kemi ndonjë ndryshim, por e vetmja situatë që mund te na paraqitet është se çka do te ndodhë me ata veteran te luftës që do te varrosen ne Koshare e që janë nga komuna e jonë, pasi kemi kesi raste dhe krejt ne fund e kishim një rast ne Xërxe dhe kush do te duhet ti mbuloj shpenzimet, Në kohe te fundit qarkullon një version se mundeni me bo me vendim te kryetarit por nuk guxojmë me ngarkua pasi nuk mundemi me ditë se a do te varrosen apo jo, por kanë fillua me krijua një standard që luftëtarët e UÇK-së që kanë marr pjesë ne Koshare që janë nga komuna jonë kanë një përcaktim apo orientim që me i varros ne Koshare. Kështu që kosto e kësaj është me lartë pasi përfshihet edhe transporti pastaj atje ne Koshare i rregullojnë varret me pllaka betoni por nuk do te thotë që është edhe kosto shume e madhe mirëpo unë marr përsipër që ne emër te juaji dhe ne emër te qytetareve që me pas ndonjë rast te tillë që mos me ju ngarkua kjo barrë familjes ashtu siç ka ndodhë ne rastin e Xerxes edhe pse i kanë ndihmua kryesia e fshatit, që mos me pas mundësi me i mbulua shpenzimet një qytetari tonë që ka dëshmuar se është luftëtar i lirisë e që donë me u varros ne Koshare. Pra nëse edhe ju jeni dakord që me këtë përgjegjësi që mundet me ma dhanë edhe ashtu e kam te drejtën ligjore pasi është edhe si subvencion që kam mundësi me dhanë me vendim te kryetarit atëherë po besoj që është moment që duhet me votu pasi ka dal si projekt i suksesshëm mbulimi i shpenzimeve te varrimit dhe ne mund ti kërkojmë edhe diçka me shume ne te ardhmen këshillit te bashkësisë islame ndonjë shtesë që me bo edhe me funksional projektin por sidoqoftë unë jam që duhet te votohet kjo pikë tani.

Burim Krasniqi – Te tabela pika 6 dhe 8 që shkruan kujdestaria 24 ore është 15 euro edhe është afishet 20 copa janë 10 euro. Pra do te ishte mirë që njërën nga këto me ndryshua edhe me bo letra e zezë pasi qe qytetaret po duhet me dhanë 10 shtesë për letrën e zezë qe përdoret për me vendos gjate varrimit që me hije edhe ajo pjese e shpenzimeve ose me hekë afishet 10 euro dhe me fut letrën e zezë, ky është me tepër si sugjerim dhe nuk po e kontestoj formën por tingëllon keq për qytetarin pasi familjari ndoshta nuk është mjaftueshëm i vetëdijshëm për shumen e 10 euro si shtesë. Kështu që duhet te largohet afishen nga tabela dhe me vendos letrën e zezë për varim.

Kryetari – Këshilli i bashkësisë islame e kanë krijua një standard për këtë dhe nuk e di a i qesin apo jo, ne mund te bisedojmë me ata rreth kësaj çështje pasi ata vet i bëjnë këto specifikacione, kjo nuk para shihet shume me ligj me ndodh mirëpo për shkak te ndjeshmërisë që e ka një institucion siç është bashkësia islame atëherë ne jemi dakordue si kuvend që me vazhdua kështu dhe nëse kemi ndonjë vërejtje edhe prej auditorëve atëherë ne do ti thërrasim por edhe ato sugjerime që i banë ne do ti qartësojmë me këshillin e bashkësisë

islame. Po ashtu kemi një situatë edhe me këta te komunitetit te tarikateve dhe i kam kërkuar këshillit te bashkësisë islame që me qenë me korrekt jo ne mbulimin e shpenzimeve te varrimit por i kanë disa situata tjera pasi ne kemi obligim edhe për tjerët si te besimit katolik që realisht kanë te drejt me kërkuar mbulimet e shpenzimeve te varrimit dhe normalisht se tash nuk parashihet bashkësia islame krejt me i mbulua pasi e plotësojnë njëra tjetrën këto bashkësitë fetare por sidoqoftë këto vërejtje që i dhatë ne mundemi me bashkëbisedua me ata.

Bejtullah Deliu – Lidhur me këtë pikë te rendit te ditës, kjo ka tregua dhe ka pasur efekt shume te mirë për qytetaret pasi ne ato momente te vështira që përballat ajo familje nuk e ka koncentrimin rreth pagesave. Por edhe te pika shtesë që kryetari bisedoj lidhur me mundësin e varrimit ne Koshare për luftëtarët e lirisë masi është si projektion, kështu që po besoj se duhet te gjendet edhe forma se si duhet te behet pagesa edhe nëse është kosto me e madhe por lavdia e tyre nuk matet ne asnjë çmim. Kështu që edhe kjo duhet te kaloj me atë kompensimin shtesë prej 10 euro që nuk është përfshije dhe me u shqyrtua me bashkësinë islame që te mos ngarkohen familjaret me atë kosto te vogël ne ato momente.

Samir Mustafa – Specifikacionin e ka bërë bashkësia islame dhe sa i përket letrës se zezë që e përmendi Burimi ata nuk e pranojnë pasi i konsiderojnë jashtë parimeve te fesë islame dhe nuk e marrin përsipër atë. Po ashtu ka pasur kërkesa që kur hapen varre te rregullohen me blloka mirëpo ato nuk i pranon bashkësia islame dhe kjo ka qenë kosto shtesë nga familjaret.

Rumir Zhuniqi – Sa për sqarim, janë disa familje katolike shqiptare ne Kramovik, Çifllak dhe Dobidol, me intereson me ditë se si shkon puna për ata te çështja e varrimit.

Kryetari – Kur ne vendosim për një qytetar te komunës se Rahovecit për me i mbulua shpenzimet e varrimit atëherë duhet me marr pëlqim pasi nuk parashihet pasi ata I kanë disa ceremoni pak me ndryshe, kështu që ne kemi diversitet, por unë i kam kërkuar bashkësisë islame që edhe varret ti hapin me buldozer pasi ne shume zona ne komunën e Rahovecit ka shume vështirësi te hapjes se varrit me dorë e sidomos gjate kohës se verës që ka shume thatësira, që gjithashtu mua ma kanë thënë se nuk e parashohin rregullat fetare e po ashtu kam kërkuar që te futet edhe arkivoli që edhe për këtë kanë thënë se nuk e parasheh por në Komunën e Malishevës është e lejuar me pretekstin e etheve hemoragjike dhe kanë vendos me arkivole që edhe bashkësia islame janë pajtuar. Pra vazhdimisht kanë hasur ne vështirësi bashkësia islame sa i përket hapjes se varreve për shkak se nuk kanë shume ekipe e sidomos kur ndodhin 4-5 raste brenda ditës. Kështu që do te bisedojmë me shume kujdes edhe për çështjen te besimit katolik që realisht është e definuar edhe me marrëveshje mirëpo ata nuk kërkojnë kompensim te shpenzimeve te varrimit pasi me gjasë kisha katolike i kryen vet këto obligime edhe nuk kanë kërkuar ndonjëherë.

Feriz Thaqi – Kryetar që u fol me herët për veteranet e Koshares rreth mbulimit te shpenzimeve te varrimit, ku dijet se veteranet e UÇK-së varrosën me ceremoni te gardës se nderit dhe duhet te jenë ne arkivole. Kështu që familjaret e kanë te pamundshme me i mbulua shpenzimet e varrimit edhe me blerjen e arkivolit, pra nëse ka mundësi buxhetore që veteranet e UÇK-së ne përgjithësi te mbulohen shpenzimet e varrimit dhe blerjes se arkivolit.

Kryetari – Çështja e arkivoleve e ka ndjeshmërinë e vet dhe varet ne çka pasi nuk është që po shkojnë vazhdimisht garda e nderit edhe me shume për shkak te gjendjes se pandemisë.

Kryesuesi – E qesim ne votim pikën e dhjetë te rendit te ditës. Me shumicë te votave te anëtarëve te kuvendit aprovohet vendimi për mbulimin e shpenzimeve te varrimit për vitin 2022.

11 Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për subvencionimin e lindjeve për gratë-nënat banore te komunës se Rahovecit për vitin 2022.

Kjo pikë është tërhequr nga rendi i ditës me aprovimin e kryetarit te komunës.

12.Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për emërimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës ne terrene për zgjedhjen e këshillave lokalë.

Kryesuesi – I kemi 4 anëtar prej kuvendit komunal që e përbëjnë këtë komision, një anëtar shkon nga ekzekutivi i komunës një nga shoqëria civile dhe një përfaqësues i fshatit. Kështu që për te mos humbur kohe

vazhdojmë me propozimet nga grupet e asamblastëve dhe meqenëse i kemi 4 anëtar nga kuvendi komunal propozoj që secili grup me propozu nga një emër.

Besë Bytyqi – Grupi i aleancës për këtë komision propozon Afrim Berisha.

Sinan Kryeziu – Grupi i VV-së propozon Leonard Morina.

Edona Kryeziu – Grupi i LDK-së propozon Faton Ramadani.

Bejtullah Deliu – Grupi i PDK-së propozon Melinda Iska.

Tani e qesim ne votim shqyrtimin e vendimit për emërimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës ne terren për zgjedhjen e këshillave lokale me kete përbërje: Afrim Berisha-AAK, Leonard Morina-VV, Faton Ramadani – LDK, Melinda Iska-PDK, Nora Boshnjaku – ekzekutivi, Vjollca Gurguli- shoqëria civile.

Me shumicë te votave te anëtareve te kuvendit, aprovohet edhe pika e dymbëdhjetë e rendit te ditës. Kalojmë ne pikën e trembëdhjetë te rendit te ditës:

13.Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për emërimin e komisionit te ankesave për procesin e zgjedhjes se këshillave lokale.

Ky komision përbëhet prej tre anëtarëve dhe fillojmë me propozimet nga grupet e asamblastëve.

Bejtullah Deliu – I nderuar kryesues, po besoj që nuk është deshtë te ceken figurativisht partitë pasi mendoj që ne kuvend mundet edhe ndonjë anëtar tjetër me u propozua por sido që te jetë vendos shumica.

Isak Hoti – Në këtë rregullore kam marr pjesë edhe vet, kështu që jam munduar te jem shume i kujdesshëm rreh kësaj, ku neni 3 thotë qartë dhe e përcakton edhe numrin, ku thotë përbërja e komisionit duhet te përfaqësoj përbërjen e subjekteve politike me numrin me te madhe te anëtareve te përfaqësuar ne kuvend.

Besë Bytyqi – Grupi i aleancës e propozon Valmir Gashin.

Sinan Kryeziu – Grupi i VV-së nuk ka propozim.

Burim Krasniqi – Grupi i LDK-së e propozon Edona Kryeziun.

Bejtullah Deliu – Grupi i PDK-së e propozon Ellma Hamza.

Kryesuesi – E qesim ne votim vendimin për emërimin e komisionit te ankesave për procesin e zgjedhjes së këshillave lokale me këtë përbërje: Valmir Gashi-AAK, Edona Kryeziu-LDK, Ellma Hamza-PDK. Me shumicë votash miratohet vendimi për emërimin e komisionit te ankesave për procesin e zgjedhjes se këshillave lokale. Kalojmë ne pikën e 14-të te rendit te ditës:

14.Shqyrtimi i Raportit nga Komiteti për Komunitete për vitin 2021.

Kryesuesi – Për këtë pikë te rendit te ditës, deri pak me herët ishte ish-kryesuesi i Komitetit për Komunitete mirëpo për shkak te zgjatjes se seancës dhe pika që ka qenë e parafundit nuk është i pranishëm mirëpo raportin e komitetit për komunitete e keni para vetes pasi vetëm është shqyrtimi nga ana e juaj dhe nuk kërkohet aprovimi i kuvendit. Kështu që kalojmë ne pikën e fundit te rendit te ditës:

15.Pyetjet dhe përgjigjet ne pyetjet e kuvendarëve.

Burim Krasniqi – Çdo vendim që po miratohet ne kuvendin e komunës ceket se vendimi i dërgohet kryetarit te komunës, shërbimit te kuvendit, MAPL-së dhe arkivit. Por ka edhe vendime që janë te cekura kuvendit por unë po kërkoj që çdo vendim që miratohet ne kuvend e komunës dhe që nënshkruhet nga ju atëherë ne seancën e radhës kur vjen materiali te gjitha vendimet duhet me ju shku dhe kuvendareve që me i pas kopjet e vendimeve që janë aprovue ne kuvend sepse është votë e secilit prej jush dhe kërkesa e dytë është kur një asamblast ka pyetje edhe përgjigjet meqenëse po vinë me shkrim po ashtu edhe ajo me qenë pjese e materialit që te gjithë asamblastët me qenë te informuar me përgjigjen që marrim nga pyetja e parashtruar, pasi nuk po kërkojmë përgjigje direktë pasi kanë marr përsipër me u përgjigj me shkrim atëherë për seancën e radhës përgjigja me ardhë paraprakisht me materialin. Po ashtu kam një pyetje për drejtorin e arsimit meqenëse kryetari e tha që me mjetet rezervë ka mundësi me i mbulu shpenzimet e kontratës kolektive, a qëndron që Opterusha dhe një shkolle tjetër kanë mbërri me marr me procedurë përmbaremore mjete materiale prej komunës se Rahovecit për zbatimin e kontratës kolektive.

Afrim Berisha – Përshëndetje kryesues, nënkryetar i komunës, një përshëndetje e veçantë shkon edhe për sekretarin e kuvendit dhe gjithë te pranishmit ne sallë. Unë i kam dy pyetje, e para ka të bëj me drejtorin e

shërbimeve publike dhe pyetje tjetër ka te bëjë me drejtorin e arsimit. Në pyetjen që kam për drejtorin e shërbimeve publike që segmenti rrugor Dejnë - Ratkoc nuk ka trotuar kështu që fëmijët që shkojnë në shkollë në shkollën e mesme 12 Maji zakonisht ndihen të frikësuar dhe ajo gjatësi rrugore nuk është edhe shumë e gjatë rreth 700-800 metra dhe shpresoj që nga organet kompetente gjegjësisht drejtoria e shërbimeve publike të marrin masa në lidhje me ndërtimin e trotuarit që përshkon segmentin rrugor Dejnë – Ratkoc.

Pyetja tjetër shkon për drejtorin e Arsimit, që ka të bëjë në lidhje me lëndët djegëse neper shkollë që vijnë me shumë vonesë përveç kësaj ato kanë qenë edhe të cilësisë shumë të dobët madje edhe nuk e di ai operator se ku i ka marrë ata drunjtë të cilësisë se dobët për në shkollën e fshatit Dejnë.

Sinan Kryeziu – Meqë e kam epitelin e të qenit kuvendarë komunal atëherë jam këtu me këshillua dhe me gjyku sipas bindjes sime personale dhe subjektivit tim politik. Komuna e Rahovecit ka lidhur një kontratë me datën 28.01.2022 për shërbime juridike tek zyra private këtu në Rahovec. Unë mendoj dhe gjykoj se kjo kontratë është dhënë gabim për arsye se komuna e Rahovecit ka zyre ligjore ku në atë zyre janë të punësuar 5 juristë, që marrin paga prej qytetareve për të mbrojtur interesat e komunës. Ajo që më befason këtu, jo kontratë që është me kushte të veçanta dhe të përgjithshme shkon deri në vlerën 50,000 euro për gjashtë muaj shërbime. Meqenëse jam edhe i fushës pasi jam edhe jurist me profesion gati të gjitha kontestet shumica prej tyre, komuna i ka konteste civile e nuk i ka konteste penale, kështu që shumicën e kontesteve komuna është e paditur në procedura dhe nuk është paditës. Kështu që për vlerësimin të kësaj kontrate që është dhënë e ndoshta nuk jepen pasi këtu thotë shumë qartë pasi jam edhe i fushës se caktuar, deri në 50,000 euro që kjo realisht mundet me qenë edhe 100,000 euro që veç një shërbim me ja krye komunës. Por duke u nisur prej faktit se me kontratën kolektive tek pagesat jubilarë edhe që përcakton ligji me i pagua punëtorët që kanë një kuotë të caktuar në marrëdhënie pune atëherë këta i kanë kontestet e humbura. Kur e thash në fillim se ky përfaqësuesi ligjor ky do të paguhe vetëm me përgjigjen në padi edhe me përfaqësim të seancave e në raste të caktuara edhe me një parashtrësë në gjykatë të cilat krejt i caktohen komunës. Kështu që unë po besoj që do të ishte mirë pasi siç thash edhe në fillim se jam edhe këshilltar edhe i fushës se caktuar të gjitha kontestet këtu që janë do të jenë të humbura, për faktin se e përcakton ligji. Kështu që kisha propozua që si emër dhe njëri i fushës se caktuar, që këta me hie në marrëveshje jashtëgjyqësore. Dy raste i ka komuna që ka bërë marrëveshje gjyqësore që këta e din shumë që janë dy femra që i kanë fitu kontestet dhe sigurisht se të gjithë të tjerët në vazhdimësi kanë me i fitua. Juristi në fjalë mundet me zvarrit procesin që bën një ankesë humb në shkallën e parë pastaj shkon në shkallën e dytë, nuk mundet me i ikë përgjegjësisë se kjo është në dëm të qytetarit për shkak se në momentin që shtrohet padia në gjykatë llogaritet me kamatë prej ditës që procedohet padia në gjykatë. Kështu që unë edhe i kisha këshillua pasi që ka edhe 5 juristë edhe nuk e di çka bëjnë ata.

Artan Asllani - Përsëritet për të gjithë. Pyetja e parë që desha të ndërlidhem e di që nuk është direkt me ekzekutivin e komunës mirëpo kërkoj nga ana e komunës e kryesisht nga kryetari dhe drejtori i shërbimeve publike të bëhet një shtrirje për rrjetin energjetik për bashkësinë e fshatit Drenoc në bashkëpunim me KED-sin për shkak se është rrjet elektrik mjaft i vjetër dhe gjithmonë kemi vështirësi sidomos gjatë kohës së dimrit. Gjithashtu kërkesë apo shqetësim në shiritin e rrugës Drenoc Rahovec ku janë formuar disa forma piramide në shiritin e rrugës e sidomos në pjesën e djathtë duke shkuar për Drenoc dhe kjo është një shqetësim për të gjithë ata që lëvizin apo e frekuentojnë atë rrugë.

Rasim Fazliu – Përsëritet për të gjithë. Unë i kam dy çështje me i ngritë, çështja e parë që i takon komunës së Rahovecit rreth një rruge që gjendet në mes të fshatit Krushe e Madhe dhe Celinë skaj lumit dhe që drejtori i Shërbimeve Publike e dinë mirë ku ka shumë baltë dhe gjithashtu edhe në legjislaturën kaluar e kam parashtruar këtë çështje dhe ende kësaj dite është e njëjta gjendje, ku ka shumë shtëpi afër dhe shumë banorë që frekuentojnë atë rrugë. Kështu që është shumë urgjente të intervenohet me zhavorr në atë rrugë dhe të bëhet rregullimi i asaj rruge që me pas mundësi qytetarët me kalua atë rrugë ashtu siç duhet deri sa të vijë një moment me i mirë që me kubëzu apo diçka tjetër, që unë mendoj se drejtori i shërbimeve publike mundet me rregullua atë rrugë. Po ashtu çështja e dytë është se nuk i takon komunës, por komuna mundet me ndërmjetësua apo me bo kërkesën siç është rasti në fshatin Brestoc të rruga kryesore që është gati për të shembur një pjesë e asfaltit skaj rrugës që mundet dikush natën edhe me rrezikua jetën. Kështu që duhet

urgjentisht te intervenohet ne atë pjesë që me bashkëpunua me ministrin qoftë edhe me kërkesë që me ndërtua një mur aty që me evitua rrezikun që shfaqet vazhdimisht për qytetaret dhe gjithë ata që e frekuentojnë atë rrugë. Po ashtu kërkesë tjetër është edhe ajo që ka te bej me Ked-sin ku disa shtylla elektrike kanë te dëmtuara dhe kanë rae ne mur, kështu që edhe për këtë duhet që te intervenohet edhe me sanue ketë problem.

Sejfullah Sejfullahi – Kur folëm për qendrën grumbulluese që me mbush perime mirëpo për me ardhë deri aty, ne e kemi një problem tjetër pasi te gjithë jemi te vetëdijshëm dhe te informuar dhe duke u ballafaquar çdo dit se plehu kimik ka një rritje enorme nga 8 euro ne 25 euro, kështu që e di që çdo gjë është e paraparë me buxhet dhe grande, por pyetja ime është se a ka ndonjë mundësi alternative me kërkuar ndjenjë buxhet që me pas mundësi me i ndihmua bujqit apo me i subvencionua te çështja e plehut kimik. Nga komunikimet që kemi gati te përditshëm me bujqit dhe ballafaqimet që kemi me ta dhe kërkesa e tyre është që me i mbështet me pleh kimik që me gjet ndonjë mundësi nga komuna.

Leonard Morina – Unë kam një pyetje për drejtorin e arsimit apo te financave se si qëndron puna me fushën e sportit ne shkollën Skender Kastrati ne fshatin Malësi te Vogël, pasi ka që dy vite ka filluar mirëpo nuk e ka marr formën duhur. Pastaj desha me pyet drejtorin e arsimit se sa është numri i mësimdhënësve te cilët nuk po mundem me hi ne listën e pagave për shkak te ngarkesës që është bërë te drejtoria e arsimit.

Bejtullah Deliu – Pyetje për drejtorin e sportit, pasi kemi një shpërndarje jo edhe te mirë te subvencioneve rreth subvencionimit te klubeve. Mendoj që kjo duhet pak me tepër me u analizue edhe ne bazë te historikut te klubeve edhe ne bazë te sukseseve që mos te kalojnë mjete shume me tepër ne një klub se te tjerat, që ndoshta një harmonizim i bartjes se mjeteve kishte me qenë me ne rregull.

Kryetari – Faleminderit për pyetjet. Sa i përket pyetjes se parashtruar nga Bejtullah Deliu, do te ketë një situatë me ndryshe ne shpërndarjen e subvencioneve dhe nuk duhet harruar faktin se komuna merr obligime me i ndihmua për këtë çështje, Unë i kam inkurajue përmes drejtorit për Kulturë Rini dhe Sport edhe vet personalisht që i kam takuar direkt disa prej klubeve ju kam bo me dije se do te ishte me mirë me u kthye ne shoqëri aksionare dhe me i dhanë fund kësaj praktike që komuna duhet me i financue klubet sportive. Por sidoqoftë ato subvencione që janë planifikua për sport do te provojmë kësaj radhe me i balancua pak me shume por edhe do te ketë një kriter sa i përket sukseset e klubeve por edhe raportet financiarë që kanë pasur me i sjellë që varet edhe prej performances se shpenzimeve që i kanë bërë e sidomos nga subvencionimi i komunës. Ne kemi njoftime sa i përket te arriturave ne sport te disa klubeve e sidomos te klubit te hendbollit e futsallit dhe do te provojmë që ti ndihmojmë sa te kemi mundësi dhe ndërkaq do te kemi zbritje për disa klube te cilat ne nuk mund te i harxhojmë subvencionet ne sport për dy ose tri klube dhe me ju pamundësua klubeve tjera te suksesshme ne disiplina tjera sportive.

Pastaj pyetja e drejtuar nga Leonard Morina ka folur për fushën e sportit ne shkollën Skender Kastrati, që realisht unë kam vendosur për seancën e radhës me ju përgjigj këtyre pyetjeve. Tani unë i them Leonardit se ka kontratë dhe operatori ende nuk ka filluar punimet por ju nuk duhet te shqetësoheni pasi ka kontratë dhe ajo do te behet një fushe e mirë dhe sigurisht se do te sinjalizohet me te gjitha ato që parashihen ne kontratë, po ashtu njëjtë e kemi edhe ne shkollën fillore ne Nagac dhe disa shkolla tjera ku i kemi te kontraktuara.

Po ashtu edhe te lista e pagave ju them se nuk e ka ngarkue drejtoria i arsimit sepse konkurset kur shpallen ani pse janë konkurse te rregullta por ministria e financave zakonisht ka probleme dhe krijohet deficit për një periudhë te caktuar derisa te futen ne listën e pagave mirëpo kur janë futë ne listën te pagave atëherë ju jepen retroaktiv, kështu që procesi është duke shkuar me radhë dhe nuk besoj që ka devijime pasi ata që kanë ngelur jashtë listës se pagave sigurisht se do te përfshihen por nuk varet nga por nga ministria e financave.

Pastaj te pyetja e drejtuar nga Sejfullah Sejfullahu, ne kemi disa subvencione për bujqësi te cilat pretendojmë me i dhanë për pleh kimik, fara e tjera, por kapacitetet e komunës tonë janë te vogla. Mirëpo me ju than te drejtën ministria e Bujqësisë nuk është që po tregon performanc te lartë sa i takon aktualisht mbështetjes se fermerëve. Ne kemi një situatë ende te pasaktë edhe çmimet po rriten te imputeve bujqësore ne përgjithësi dhe nuk kemi rritje te subvencioneve nga ana e ministrisë se Bujqësisë. Kështu që do te shohim pasi kanë dhënë premtime shume dhe ndoshta do te kemi situatë me pozitive kësaj radhe sa përket komunës se Rahovecit.

Po ashtu ne pyetjen e drejtuar nga Rasim Fazliu sa i përket rrugës me baltë që gjendet ne mes te Krushes dhe Celinës, ne mundemi me intervenua me zhavorr dhe ftojë drejtorin e shërbimeve publike që nëse kemi mundësi që sa me shpejt me intervenua ne këtë rrugë dhe gjithashtu edhe tek dëmtimi i rrugës Brestoc, pasi jemi te informuar dhe jemi dëshmitar se është dëmtuar një pjesë e rrugës dhe është hera e dytë që i adresohemi ministrisë Infrastrukturës planifikimit e mjedisit dhe gjithashtu kemi pasur kërkesë edhe nga banoret e fshatit Brestoc dhe gjithë asaj zone, pasi siç e dini është rrugë rajonale dhe i kam fitu që me rrit presionin që me na detyrua edhe neve pasi ne rrugë rajonale ne duhet me pas pëlqimin dhe shpresoj se duhet te kemi një zgjidhje pasi është mjaft rrezik pasi është shembur një pjesë dhe vazhdimisht krijon rrezik për gjithë qytetarët që e frekuentojnë atë rrugë. Po ashtu te dëmtimi i shtyllave elektrike, pra është e vërtet se janë te dëmtuara shume shtylla elektrike e po ashtu edhe te ndriçimit publik te dëmtuara nga operatorët dhe disa raporte po shkojnë ne polici dhe ne kemi marr përsipër pasi fatkeqësisht kur nuk kemi marrë masa ndëshkuese dhe nuk dihet se kush e ka shkaktua problemin atëherë ne duhet si komunë me rregullua se paku shtyllat e ndriçimit publik, kurse te shtyllat e rrjetit elektrik normalisht se KED-si që realisht apeloj edhe nga kjo mbledhje pasi ata kanë një plan te vetin për investime. Pra ne do te insistojmë që disa pika kritike që i kemi si ne fshatin Drenoc që te insistojmë ne rregullimin e tyre pasi ajo çka varet prej neve sigurisht se kemi me krye por po besoj që edhe njëherë me i ri përsërit kërkesat që me shtie ne planin investiv edhe Drenocin edhe ndonjë pjesë tjetër ku ka probleme me energji elektrike. Pastaj te dëmtimi i rrugës për ne Drenoc që janë krijuar disa gunga ne rrugë, ka qenë një kontratë që është marr me riparime te asfaltit nuk është se kanë funksionuar edhe mirë dhe ne vitin 2017 kur kam marr pushtetin atë e kam gjet te trashëguar si kontratë që e ka krye KAG-asphalt edhe pse si komunë fort nuk i ka rezistuar riparimi që ka bërë ne rrugën Drenoc Rahovec dhe ka nevojë me u riparua dhe do të shohim pasi ajo rrugë ende fatkeqësisht rrugë lokale.

Te pyetja e parashtruar nga kuvendari Sinan Kryeuiu rreth avokaturës, ne e kemi zyrën ligjore dhe mendoj se kemi zyrën ligjore te paren pos Prishtinës ne Republikën e Kosovës që është krijuar ne vitin 2012 që me vonë kanë filluar edhe këto komunat tjera. Por zyra ligjore e ka te pamundur me i krye te gjitha, edhe pse kemi 5 juristë mirëpo dy veç i kemi para pensionit dhe mund te themi se kemi dinamikë te madhe e sidomos me kontratën kolektive. Ju përmendët disa shërbime që jepen për komunën jashtë komunës për 6 muaj dhe ju duhet ta dini secila e ka tarifën e vet por arsyeja që janë te planifikuara 50,000 ndoshta vetëm 500 euro mund te shpenzohen. Kështu që komuna ka mbërri edhe pajtime gjyqësore d.m.th. ka autorizua avokatin që mundet me bo pajtim gjyqësor që ja mundëson komunës me mbrojt buxhetin e vet që mos me shpenzua buxhetin e vet ne procedura tjera me ankesa tjera. Ne kemi edhe lende te trashëguara me herët dhe tash dinamika e avokatit te komunës ku ka plot komuna që pikërisht për kontratën kolektive ose që me u përball suksesshëm me vendimet gjyqësore marrin shërbime jashtë komunës nga avokatet që janë jashtë komunës, për shkak se nesër mundemi me pas situatë problematike nëse ja lëmë këtë barrë vetëm zyrës ligjore që madje zyra ligjore nuk ka hiq mundësi edhe zakonisht nuk merret me çështje te mbrojtjes sepse avokatura komunale dhe avokatura shtetërore janë mekanizma me adekuatë për me mbrojtë interesin e komunës dhe unë jam i bindur që për 6 muaj nuk do të mbërri me i marr as shume prej 2000 euro, pasi që ju kur e bëni kontratën ju e llogaritni se mundeni me pas një intensitet te madhe te punëve apo veprimeve që keni me bo si komunë. Kështu që për 6 muaj nuk ka asnjë shansë me i shpenzua Shumen prej 50,000 pasi që janë tarifat e përcaktuara, pasi këtë standard e kemi marr edhe nga komunat e tjera. Pra ne kemi pasur vullnet që puna që puna e komunës te mbrohet me mire duke shtuar instrumentet pasi një avokat që ekskluzivisht merret vetëm me komunë atëherë me shume e ndihmon komunën dhe me shume e mbron interesin e komunës dhe me pak dëmtohet komuna ne planin publik nga ndëshkimet e mundshme që mundet me i marr nga gjykata ose organ tjetër që i adresohet apo e padisin komunën. Kështu që ne këtë pike gjithçka është ne rregull dhe jam i bindur se është mënyra me e mirë për me mbrojtë komunën, pasi është mundësi më mirë me mbrojt komunën nga ballafaqimet apo vendimet gjyqësore, pasi që zyra ligjore është shume e ngarkuar pasi veç ne baza ditor i bëjnë me shume 30 vendime te kryetarit i bëjnë gati dhe me u marr edhe me padi ankesa e shume punët tjera atëherë kjo është shume e ngarkuar dhe madje këto punë nuk janë ne kompetencë e zyrave ligjore. Pra janë shërbime me te veçanta dhe specifike që është deshtë me i bo komuna jonë edhe shume me herët, për shkak te

mundësisë se mbrojtjes me te mirë te interesave të komunës prandaj është një avokaturë që kryen shërbime të veçanta dhe ka marrëdhënie kontraktuale me komunën në afat 6 mujor. Pasi pyetja e parashtruar rreth trotuareve, në kemi kontratë për ndërtimin e trotuareve që priten shumë shpejt të fillojnë punët për trotuar pothuajse në të gjitha zonat, e po ashtu edhe zona Ratkoc-Dejnë dhe Ratkoc –Malësi parashihet me pas trotuar që afërsisht 14 km i kemi në kontratë për ndërtimin e trotuareve dhe pritet shpejt me fillua punën operatori për shkak të kohës jo të mirë që ka qenë këto ditë. Po ashtu tek drunjtë për djegie neper shkollë, siç e dini drejtori i arsimit dhe kryetari i komunës krejt çka mundet me bë është me shty procesin dhe me përshpejtua veprimet sepse kontratat për furnizim me dru neper shkollë është lidhur me vonesë për shkak të një ankese dhe është e vërtetë që kemi pasur probleme me furnizim e sidomos në fazën delikate. Kështu që nëse drunjtë nuk janë kualitativ atëherë sigurisht se ka një bord të shkollës nuk duhet të ja pranoni dhe neve nuk na intereson se a dëmtohet operatori nëse provon me bo këso taktizime apo devijim, kështu që nuk duhet të ja pranoj drejtori i shkollës qoftë me dru apo çfarëdo furnizimi tjetër neper shkollë që nuk është e kualitetit të duhur, drejtori dhe bordi i shkollës nuk duhet të ja pranoj. Kështu që nëse ka nevojë atëherë kryetari i Komunës duhet edhe një komision shtesë me bo që me mbikëqyrë punën e komisionit që e ka pranë.

Sinan Kryeziu – E para punës e thash që në fillim se kontrata është ligjore mirëpo nuk është logjike. Por fakti është se kontestet janë të humbura, pasi ligji e thotë që ai person që bën padi që mos me pas të drejtë atëherë gjykata e refuzon padinë dhe nuk i jep në këtë rast komunës me bo përgjigje në padi, pasi e njoh shumë mirë këtë profesion. Kështu që unë thash se mënyrën se bëni kontrata mbi vepër ,mundëni me angazhua jurista pasi ka aq shumë në komunën tonë dhe një ndër ta jam edhe unë personalisht, kështu që unë mund të i mbrojtë interesat e komunës me një çmim shumë modest mirëpo deri në 50,000 euro atëherë është vakum kjo kontratë. Pasi këtu thotë decidivisht në shumën 50,000 mirëpo mundet edhe 10,000 por problemi është këtu pasi varet krejt të përfaqësimi se gjykata sa seanca i cakton brenda ditës që ka kapacitet dhe nëse gjykata ka vullnet me krye këtë çështje dhe me i dërgua lendet para atëherë mundet me ja caktua edhe 10 në ditë, kështu kam dëshirë me mirëkuptua sa i përket kësaj çështje pasi jam për me i mbrojt interesat e qytetareve.

Kryetari – Edhe në jemi me i mbrojtë interesat e qytetareve, kështu që edhe njëherë po e potencoj pasi logjike ka për shkak se në kemi dinamike të madhe të aktiviteteve të plotë palëve që nuk ka mundësi me i pranë zyra ligjore dhe që nuk janë detyra dhe përgjegjësi të zyrës ligjore. Pastaj kush është i interesuar me dhanë shërbime juridike falas do të jetë i mirëpritur për këtë dhe sigurisht se i kisha mbështet me ndonjë mundësi kur e fitojnë ndonjë kontest. Pastaj pse janë 50,000 euro nuk do të thotë që shpenzohen pasi që janë me tarifa që mundet me i marrë aq sa e ka të tarifuar dhe gjithashtu kush është jurist në komunën e Rahovecit që e mbron interesin publik e ftojë me qenë pjesë e ekipit për me i mbrojtë interesin publik jo nga kontrata kolektive pasi tani jemi në një situatë me ndryshe dhe gjithashtu e afirmoj dhe jam për me zbatue kontratën kolektive dhe në vërejtjen e kemi që parët mos të na i marrin neve por këtë kontratë ta zbaton qeveria sa i përket kontratës kolektive. Po ashtu uroj që ligji i pagave të i parashihet edhe këto beneficione për mësimdhënësit pasi për çdo vit në do të kemi këto obligime sa i përket kontratës kolektive dhe çdo vit derivojnë beneficione për mësimdhënësit. Në kemi pasur nevojë madje edhe për 3 avokatura për me ja lehtësue barrën e madhe që ka në përballje komuna e jonë, pasi komunës së Ferizajt ju kanë blloku llogarit krejt dhe disa komunave tjera, kështu që në deri tash kemi shpëtuar dhe kemi mbërrirë me krijuar stabilitet edhe përkundër faktit pasi që jemi duke pagu por gjithashtu kemi krijuar edhe një avancim për shkak të aktivitetit intensiv të avokaturës që kryen shërbime në komunën tonë për komunën tonë dhe gjithashtu kemi mbërrirë me bo marrëveshje gjyqësore që se paku me zbrit vlerën pasojave financiare që mund të i prodhoj kontrata kolektive nëse ti ankoresh në instanca tjera. Pra jemi në një situatë me të favorshme dhe nuk jemi në situatë të mirë pasi ë jam edhe pjesë e asociacionit të komunave të Republikës së Kosovës, kështu Kaçaniku është krenuar që e ka pagu krejt kontratën kolektive por nuk do të thotë që kryhet pasi ajo çdo vit prodhon dhe Bedri Hamza si njeri prej eksperteve dhe tani Kryetar i Komunës ka thënë që do të insistojmë që me shtie në listën e pagave që me paraparë krejt beneficinin që burojnë prej kontratës kolektive dhe njëherë e mirë me u zgjidh kjo temë. Pra vërejtja jonë është që në mos me pagu para prej komunës tonë për mësimdhënësit, por sigurisht se jemi për me zbatu kontratën kolektive por duhet të paguaj qeveria pasi ata janë nënshkrues të kontratës kolektive dhe

ne këtë situatë ne kemi pasur nevojë për juristë shtesë dhe zyra ligjore e komunës së Rahovecit është shumë profesionale por nuk mundet me mbart edhe këtë barrë për përballje me gjykatën sepse çdo ditë kur ne kemi pasur mungese avokati, zyrtari jonë ligjor Mirsad Shala gjithë ditën u ballafaqu me këtë problematike dhe gati çdo ditë e ka pasur kështu. Kështu që janë me qindra raste që kanë të bëjnë me kontratën e kolektive që nuk ka mundësi zyra ligjore edhe nëse është kompetente me krye këtë punë prandaj neve me patjetër nuk ka deshtë edhe me shumë avokatë për me u përball me dinamiken e madhe dhe intensitetin e punëve por edhe normalisht me pas sukses komuna e jonë që mos me i marr paret nga pakujdesia apo me procedura përmbartimore dhe kur e din që e drejta për ankesë ka edhe shumë problem dhe pasi jeni ju Sinan Kryeziu si jurist profesional atëherë ka shumë probleme dhe ka shumë gabime ne gjykatë pasi ka pasur shumë kalkulime te gabuara që komunës tonë munden me i shpetu shuma te mëdha pasi ka gabime dhe ne prezantimin e dosjeve që i kanë sjellë avokatet për mësimdhënësit dhe që e kanë paditë komunën tonë ne gjykatë dhe për krejt këto çështje duhet me u kujdes avokati i komunës që e mbron dhe ka përkushtim vetëm për atë komunë. Kështu që zyra ligjore nuk mundet me krye këtë punë, pasi edhe prodhon akte të tjera sigurisht vendimet e kryetarit e plot rregullore plane te veprimit dhe këto janë temat që merret zyra ligjore dhe jo me temat që kanë të bëjnë aktualisht komunat me kontratën kolektive.

Faton Ramadani – Unë kam një pyetje sa i përket drunjtëve dekorativ që janë mbjellë ne krejt komunën e Rahovecit. Unë jam dëshmitar dhe besoj që edhe krejt ju e keni pae që me shumë se 70% janë tharë, kështu që kërkoj nga ju që a keni ndonjë informatë apo keni ndonjë vlerësim se pse janë tharë dhe a do të përgjigjet operatori dhe me sa e di unë kontratën e ka një vjeçare për mirëmbajtjen e tyre dhe zëvendësimin e atyre që janë thyere, kështu që a do të merrni masa rreth kësaj pasi tani është afër që ti skadon kontrata. Po ashtu një kërkesë, kur e dimë se tash koha e rasadeve ne komunën e Rahovecit, shumica e bujqve vinë edhe marrin dheun ne fshatin Celinë për mbjelljen e rasadeve, edhe pse është interes i dyanshëm por kam një kërkesë që nëse mundeni me i përcjell ata që pasi e bëjnë mbusjhen e tepërt te kamionëve dhe pa mjete që krijojnë siguri dhe vazhdimisht po shkaktojnë probleme ne rrugë.

Kryetari – E inkurajoj Fatonin si ekspert i fushës edhe e din sa përqind janë tha drunjtë dekorues dhe këtë nuk e di unë, mirëpo unë e di që ne kemi kontratë për mbjelljen dhe mirëmbajtjen e tyre dhe është kontratë dy vjeçare. Nuk është e vërtetë që janë tha mbi 70% ashtu siç e thatë ju, pasi ne e dimë saktë se sa drunjtë dekorues janë zëvendësua edhe sa kanë deshtu dhe komuna ka një komision të veçantë komuna që është duke e i evidentuar bashkë me operatorin dhe tash kur te ja nis ne Mars me bo zëvendësimin, pasi ne nuk paguajmë dy herr për një dru dekorativ dhe për këtë jep llogari operatori se pse janë tha mirëpo këtë nuk mund ta them unë pasi s'jam ekspert. Dhe nuk po ironizoj asgjë. Kështu që operatori është i licencuar dhe afër 16 euro i kushton një dru dekorativ dhe ai ka me përsërit secilën fidanë që do të dështoj deri sa e ka ne kontratën valide.

Sejfullah Sejfullah – Pa deshtë me ju kritikua apo me kerku me tepër llogari apo me mbështet Fatonin, sinqerisht po pajtohem me atë se komuna do të bën asnjë pagesë shtesë mirëpo operatori pa asnjë paragjykim për operatorin, mendoj se pari kur I ka mbjelle me shumë se gjysmën e tyre e kemi bo mirëmbajtjen e tyre vet ne si qytetare te atij vendbanimi dhe operatori nuk ka ardh vazhdimisht me bo mirëmbajtjen e tyre pore he sa I përket zëvendësimit nuk është ide e qëlluar për shkak se pastaj edhe rritjen e tyre nuk e kemi ne te njëjtën gjendje sikur ajo që është zënë me te paren nga ajo që është zëvendësuar dhe nuk e kanë rritjen e barabartë.

Kryetari – Edhe unë mendoj se i kanë ndihmuar edhe komuniteti ne mirëmbajtjen e tyre për kujdesin që kanë treguar dhe po ashtu ne si autoritet kontraktues kemi te drejtë dhe kemi kompetenca edhe me i dhanë vërejtje edhe me i kërkuar respektim te plotë te kontratës dhe gjithashtu mund te krijohet disproporcion i zhvillimit te fidanit kur thatë apo mbillet përsëri. Por qëllimi jonë është qe paret e komunës mos me shku dëm dhe me sa e di është një kompani Buqaj që është e kontraktuar dhe e licencuar. Dhe sipas eksperteve te pyjeve ka raste që nuk i pranon hiq toka ne zhvillimin e tyre dhe vjen menjëherë deri te tharja si p.sh. pishat ne shumë vende mund te i mbjellim mirëpo nuk i pranon toka jonë. Kështu që kontrata ekziston dhe garancioni ekziston dhe nëse ai ka llogari me vazhdu kështu atëherë ne do ta bëjmë përgjegjës dhe sigurisht se atij do ti kushton financiarisht dhe jo komunës së Rahovecit. Kështu që kjo tani nuk varet nga ne tani, pasi ai ka me bo mbjelljen e sasisë e nevojshme te drunjtëve dekorues dhe do te kujdeset për mirëmbajtjen e tyre dhe do te jetë

ne garancinë e tij për dështimin e tyre dhe zëvendësimin e atyre që do të dështojnë dhe kjo është decidive ne kontratë.

Kryesuesi – Unë e kam një çështje pasi që është seanca e dytë e rregullt si kryesues i kuvendit dhe me ka ra goxha shume që të shfletoj dhe të lexoj rregulloren e punës se kuvendit që për dallim prej kryetarit që ndoshta merret me çështje me të mëdha dhe nuk i ka ra, ku thotë që neni 44 te rregullat e debatimit, çdo diskutues me përjashtim të rasteve kur me këtë rregullore parashikohet ndryshe dhe në këtë rast nuk parashikohet ndryshe që ka të drejtë për një kohë jo më tepër se 3 minuta dhe jo me shume se një herë për thelbin e të njëjtës çështje. Kështu që unë po kërkojë mirëkuptimin fillimisht prej anëtarëve të kuvendit komunal pasi nuk është tendencë e imja që me ja ndalë fjalën dikujt apo me ja cenuë të drejtën e fjalës, e sigurisht veçanërisht kryetarit të komunës që mundet edhe për shkak të respektit që është edhe kryetar pavarësisht bindjeve politike e gëzon respektin që me mundësi të shtimit nga 3 minuta sa here e kërkon mirëpo ka të drejtë kryetari me u marr me kryesuesin në këtë formë, kështu që unë e mora si kërcënim këtë pasi nuk kërkoj me ja ndal fjalën asnjëherë por vetëm ju tregoj minutazhin dhe kjo është e drejta ime si kryesues i kuvendit komunal.

Kryetari- Rregullorja e kuvendit të komunës së Rahovecit e votuar në kuvendin e komunës vlen për anëtarët e kuvendit të komunës dhe ju duhet ta dini këtë fakt se nuk behet fjalë as për kërcënim apo diçka tjetër por duhet ta dini kryetari i komunës e ka të drejtën e vet pasi rregullorja nuk vlen edhe për kryetarin e komunës. Kryetari i komunës sa herë që ta vlerëson që duhet me i dhanë përgjigje një shqetësimi sepse pa ekzekutivin e komunës nuk funksionon kuvendi i komunës, rregullorja e kuvendit të komunës ka zbatim vetëm për anëtarët e kuvendit por kryetarit të komunës nuk duhet të tentoj me ja ndal fjalën pasi e ka të drejtën legjitime legale edhe ligjore, pasi kurdo e vlerëson me pas një pozicion një koment një vlerësim ai mund ta bëjë dhe nuk ka vend për asnjë lloj precedenti këtu edhe pse kryetari e merr fjalën prej kryesuesit por mos të tenton me ja ndalua apo me kufizua në kohë.

Kryesuesi – Fillimisht nuk ishte tendencë e kufizimit të kohës dhe nuk ka vend për keqkuptime këtu por në rregullore thotë qartë se çdo diskutues dhe nëse ti nuk e pranon këtë rregullore si të tillë atëherë ky kuvend komunal funksionon në bazë të kësaj rregulloreje dhe hiq me pak që nuk kam asnjë lloj tendence me ja ndalua fjalën kryetarit apo kushdo qoftë ai mirëpo prej çdo anëtarit të kuvendit komunal kam kërkuar mirëkuptimin si shkas që është mbledhja e dytë që unë udhëheqë duk u bazuar në këtë rregullore dhe asnjëherë nuk ka qenë qëllimi im që anëtarëve të kuvendit apo hiq me pak kryetarit me ja ndal fjalën.

Kryetari – Sigurisht se kryetari i komunës dhe drejtorët e drejtorive e marrin fjalën nga kryesuesi por mos të tenton ndonjëherë kryesuesi që me ndal apo me kufizua në kohë të drejtën e fjalës pasi e ka shume gabim sepse rregullorja e kuvendit vlen vetëm për anëtarët e kuvendit sa i përket të drejtës dhe kufizimit në kohë e jo edhe kryetari i komunës dhe kjo nuk është aspak ndonjë fyerje por është pozicioni i qartë i zgjidhur institucionalisht i rregulluar me cilindo rregullore sepse kryetari i komunës sa herë të vlerëson se kërkon shpjegim për ndonjë çështje të caktuar atëherë nuk mundet askush me ja ndalua apo me kufizua në kohë.

Besë Bytyqi – I nderuar kryesues, miqësisht shoqërisht dhe në mënyrë kolegjiale ju them se rregullorja është e kuvendit komunal për me zbatu tërësisht dhe për të gjithë ose jo kur të ju tekton juve. Rregullorja specifikisht e thotë anëtarët e kuvendit komunal e kanë fjalën 3 minuta kurse shefat e grupeve 5 – 10 minuta dhe nuk e cekë drejtorin, kryetarin e komunës që të japin sqarime se sa neve na kërkojnë sqarime, sepse një kryetar i komunës nuk mundet me i dhanë të gjitha sqarimet për 3 minuta ashtu siç pretendoni ju pasi duhet me elaborue që me kuptu në me shume. Kështu që sugjeroj që në mundemi me mbajt edhe një punëtori që me diskutue për rregulloren edhe e diskutojmë gjithë rregulloren që ju po e thoni por që nuk e keni lexuar mirë. Kështu që kërkoj nga ju që të keni konsideratë që me na respektu neve si anëtar të kuvendit në mënyrë që me ju respektua edhe në juve.

Hasan Përboqi – Përshëndetje për të gjithë. Mendoj se këtë mbledhje keni ofenduar të gjithë asamblistët pa përjashtim, pasi rregullorja është e njëjtë për të gjithë dhe nuk zbatohet rregullorja kur ti tekton kryesuesit duke ditur se kryesuesi nuk asgjë me shume se sa mbarëvajtjes i mbledhjes së kuvendit. Kështu që nëse ju i pari e shkelni këtë rregullore atëherë ju jeni ai që duhet të mbani përgjegjësi pasi jemi dëshmitar në piken e parë të rendit të ditës ka folur mbi 20 herë dhe vazhdimisht ja keni dhënë fjalën dhe a e konsideroni shkelje të

rregullores se kuvendit dhe mbi te gjitha kryetarit te komunës nuk ka rregullore që ja ndalon apo kufizon te drejtën e fjalës, pasi ai asamblast që bën pyetje sigurisht se duhet me ju përgjigj dhe me te drejt se çdo asamblast kërkon sqarim për çështje te caktuara. Kështu që rregullorja është e njëjtë për te gjithë dhe ju kisha lutur që ta zbatoni rregulloren pasi kryesuesi vjen nga asamblastët, kur e dimë që asamblastët janë votu nga populli dhe nëse merr përkrahjen e shumicës e merr mbështetjen për me u bo kryesues, kështu që ju kisha lidhur që zbatoni rregulloren për te gjithë[dhe jo veç për njërin.

Sejfullah Sejfullahi - Mendoj se ishte e lidhur me temën dhe me shume ishte këshilluese informuese për kryetari, kështu që mendoj se nuk qëndron ajo që thatë ju se kam marr 3 herr me nga 3 minuta.

Edona Kryeziu – Unë po mendoj se gjithçka ka kaluar tash ne bashkëbisedime dhe duhet te keni konsideratë pasi që jemi nga ora dhjetë dhe tani jemi ne ora 5 ,kështu që duhet keni konsideratë pasi që pikat e rendit te ditës janë shtjelluar, komisionet o formuan dhe gjithashtu edhe pyetjet mbaruan, kështu me pas konsideratë edhe me mbyll këtë seancë.

Hasan Përboqi – Ju përmenda pas pasur ndonjë qellim te keq për ju, mirëpo sot këtu me qindra raste kanë ndodhur sa i përket rregullores që përmendi kryesuesi është shkelur ne mënyrën me flagrante te mundshme qoftë prej kryesuesit apo edhe prej disa asamblastëve, kështu që keni apo nuk marrëveshje te fshehtë, ju kisha lutur që rregulloren nuk duhet ta shkelni.

Kryesuesi – Po e përmendi edhe njëherë se është vetëm mbledhja e dytë e rregullt që unë e udhëheqë, jam mundu me qenë i barabartë dhe do te mundohem te jem me te gjithë anëtarët e kuvendit komunal. Po ashtu e potencoj se shfaqja e grupit te AAK-së e ka marr fjalën ja 6 herë vetëm për piken e dytë te rendit te ditës. Kështu që po mundohem me ju dhanë hapësirë secilit anëtar te kuvendit dhe mos me ja cenu nëpërmes rregullores. Kështu që nga seanca e radhës po besoj se do te filloj me përdor rregullat e debatimit ne këtë rregullore që ka edhe dikush që nuk po i njeh ato rregulla, kështu që prape kërkoj mirëkuptimin tuaj dhe fjalën nuk e kam ndërmend me ja ndal askujt dhe nëse ka nevojë mundemi me ja shtu edhe 3 minuta, pos kryetarit që nuk kam pas asnjëherë tendencë me ja ndal fjalën. Edhe njëherë ju kërkoj ndjesë për vonesën e seancës dhe e konstatoj te mbyllur seancën e kuvendit.

Procesmbajtësi:


Agim Hoti

